

UDHËZUES PËR BUXHETET

NOTES



Autorë
D-R ZHIDAS DASKALOVSKI
M-R ANA NIKOLOVSKA
M-R MARIJA RISTESKA

UDHËZUES PËR BUXHETET

Autorë

D-R ZHIDAS DASKALOVSKI

M-R ANA NIKOLOVSKA

M-R MARIJA RISTESKA

SHKUP, 2006

Botues

Fondacioni Friedrich Ebert - Zyra në Shkup
Bul. Sh. Klimenti i Ohrit 21/1, 1000 Shkup
www.fes.org.mk

Për botuesin

Shtefan Denert

Redaktimi Profesional

Toni Dimovski

Përkthimi

Gjakush Kabashi

Përgatitja teknike

PROMO DSGN

Tirazhi

300

CIP – Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

336.14(497.7) (036)

DASKALOVSKI, Židas

Udhëzues për buxhetet / autorë Zhidas Daskalovski, Ana
Nikolovska, Marija Risteska. – Shkup : Fondacioni Friedrich Ebert –
Zyra në Shkup, 2006. – 76 стр. ; 20 см

Sodrži i:

Aneks

ISBN 9989-109-36-2

1. Nikolovska, Ana 2. Risteska, Marija

а) Буџет – Македонија – Водичи

COBISS.MK-ID 67975178

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	7
NEVOJA PER UDHËZUESIN PËR BUXHETE	8
KAPITULLI I: HYRJE NE FINANCAT PUBLIKE DHE BUXHET	9
KAPITULLI II: BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	12
1. Buxheti i Republikës	13
1.1 Aspektet ekonomike të politikës buxhetore.....	13
1.2 Kontrolli buxhetor	15
1.3 Menaxhimi me mjetet buxhetore	15
1.4 Baraspesha buxhetore	17
1.5 Prej çka përbëhet Buxheti i Republikës?	17
1.5.1 Buxheti qendror i Republikës së Maqedonisë	18
1.5.1.1 Të hyrat e Buxhetit qendror	18
1.5.1.2 Të dalat (shpenzimet) e Buxhetit qendror	21
1.5.2 Llojet e klasifikimit të të dalave.....	32
1.6 Deficiti në krahasim me suficitin	34
1.7 Buxheti i fondeve jashtëbuxhetore	36
1.8 Buxheti i konsoliduar i Republikës	48
1.9 Buxheti i njësive të vetëqeverisjes lokale	52
1.9.1 Të hyrat	52
1.9.1.1 Dotacionet nga Buxheti i Republikës dhe buxhetet e fondeve.....	53
1.9.2 Si përgatitet buxheti i njësive të vetëqeverisjes lokale?	54
1.9.3 Si duket buxheti i njësive të vetëqeverisjes lokale?.....	55
1.9.4 Decentralizimi në faza	59
1.10 Borxhi publik	60
KAPITULLI III: PROCEDURA PER MIRATIMIN E BUXHETIT	63
1. Aktorët e procesit buxhetor	63
2. Fazat themelore të procesit buxhetor	66
Faza e parë: Përgatitja e Buxhetit.....	70
Faza e dytë: Miratimi i buxheteve	72
Faza e tretë: Realizimi i buxheteve	74
3. Transparenca e buxheteve.....	76
KAPITULLI IV. Kontrolli, gjegjësisht mbikëqyrja e Buxhetit	79
1. Kush janë aktorët?	81
2. Kontrolli financiar publik dhe roli i Entit shtetëror për revizion	81
3. Kontrolli financiar publik dhe roli i Revizionit të brendshëm dhe Ministrisë për financa	82
4. Roli i qytetarëve të Maqedonisë në procesin e mbikëqyrjes së buxheteve.....	83
ANEKSI	86



PARATHËNIE

Fondacioni Friedrich Ebert në Maqedoni, si edhe në vendet tjera të Evropës juglindore në të cilat realizohen proceset e reformimit, e përkrahë procesin e decentralizimit, transformimit në shoqëri tregtare dhe krijimin e shoqërisë civile, në veçanti në lëminë e tregut të punës, politikës sociale, ekologjike dhe mediale. Shoqëria civile e përbërë nga organizatat qytetare, OJQ-të, institucionet akademike, sindikatat, organizatat e punëdhënësve dhe secili qytetar i angazhuar në aktivitetet me interes publik, kanë rol esencial për funksionimin e shoqërisë demokratike. Pa demokratë nuk mund të ketë demokraci.

Në qendër të demokracisë gjendet qytetari i informuar mirë, i cili e merr vendimin e tij politik në bazë të njohurive të fituara nga burimet e ndryshme. Mediat, shoqëria civile dhe informatat zyrtare të institucioneve relevante janë vetëm një pjesë e këtyre burimeve. Kjo është arsyeja se pse demokracia funksionale nuk nevojitet vetëm në sistemin e partive politike të cilat garojnë për votat e qytetarëve, por edhe në shoqërinë civile e cila bën përpjekje për artikulimin e interesave dhe nevojave të cilat nuk përfaqësohen nga partitë politike. Njëherazi, ekziston edhe nevoja fundamentale e secilit qytetar për transparencë dhe qasje ndaj informatave, me qëllim që qytetarët ta shohin mënyrën në të cilën institucionet shtetërore i shpenzojnë mjetet e mbledhura përmes tatimeve, dhe në këtë mënyrë qytetari do të jetë në gjendje të merr vendim adekuat për votim gjatë zgjedhjeve.

Por, qasja ndaj informatave nuk është e mjaftueshme. Nevojiten edhe njohuritë e organizimit politik të institucioneve, dhe mënyrën në të cilën ato e shfrytëzojnë buxhetin shtetëror. Me këto mjete, qytetari mund të kryejë mbikëqyrje të shpenzimit të mjeteve nga shteti, qoftë vetë ose me të tjerë në organizata qytetare.

Mbikëqyrja është mbledhje e informatave, ajo është mbikëqyrje sistematike dhe me qëllim të caktuar. Këtu mbledhen informata për implementimin dhe avancimin e projekteve të planifikuara. Monitorimi, si hap i dytë, jep edhe informatë kthyese. Qytetarët ose organizatat e qytetarëve kanë mundësi dhe duhet t'i shfrytëzojnë informatat e marrura nga mbikëqyrja, me qëllim që t'i përmirësojnë gjërat dhe të propozojnë përmirësime. Kjo i jep mundësi aktorëve politikë për adaptim gjatë zhvillimit, dhe plotësimin e nevojave të qytetarëve. Mbikëqyrja mund të jetë e dobishme edhe për parandalimin e shpërdordimit të të mirave publike. Korrupsioni është dukuri i njohur jo vetë në Maqedoni, dhe nuk është e rastësishme që qytetarët e Republikës së Maqedonisë e klasifikojnë korrupsionin si një prej problemeve kryesore të shtetit. Kjo është arsyeja se pse mbikëqyrja e buxhetit mund të përcaktojë se a shfrytëzohen mirë mjetet financiare, ose jo.

Shpresojmë se Doracaku për Udhëzimet në buxhet do t'i shfrytëzojë politikanëve dhe nëpunësve në administratë, ekspertëve të OJQ-ve dhe qytetarëve. Jemi të bindur se ai do t'i mundësojë qytetarëve kontrollimin e shfrytëzimit të mjeteve, dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim. Me një fjalë, ta ushtrojnë të drejtën e tyre qytetare si shtetas të vendit të tyre.

Shtefan Denert

Fondacioni Friedrich Ebert

NEVOJA PER UDHËZUESIN PËR BUXHETE

Në Republikën e Maqedonisë nuk ekziston asnjë vend në të cilin mund të gjenden informatat e plota për buxhetin dhe proceset buxhetore. Për të marrur ndonjë informarë të lidhur me buxhetin, së pari nevojitet kohë për gjetjen, dhe pastaj për analizën e shumë ligjeve, akteve, neneve dhe dokumenteve tjera relevante. Përveç kësaj, analizat e lidhura me proceset buxhetore janë tejet të vështira për shkak të mungesës të të dhënave statistikore, dhe qasjes së vështirë ndaj informatave.

Qëllimi i këtij udhëzuesi - doracaku është t'i mundësohet lexuesve kuptimi i plotë i financave publike, në të cilat buxheti zë vend të rëndësishëm, dhe të njihen me të gjitha aktivitetet buxhetore në të cilat ceket edhe rëndësia e tyre, si dhe nevoja për vigjilencën publike për këto çështje. Qëllimi i jonë është ta motivojmë opinionin publik të merr pjesë dhe të ndikojë me aktivitetet e saj mbi hartuesit dhe implementuesit e politikës buxhetore, për shkak se ajo ka rëndësi dhe ndikim të madh në realizimin e qëllimeve të politikës së përgjithshme ekonomike në vend.

Udhëzuesi është i dedikuar për të gjithë qytetarët, por kjo nuk e përjashton mundësinë që ai të shfrytëzohet edhe nga sfera profesionale e opinionit publik për ndonjë çështje të caktuar.

Gjatë hartimit të këtij Udhëzuesi janë hulumtuar të gjitha ligjet relevante (lista e tyre mund të gjendet në Aneksin e doracakut), por janë marrur parasysh edhe doracakët me përmbajtje të ngjajshme, të cilat janë publikuar në vende tjera.

KAPITULLI I: HYRJE NE FINANCAT PUBLIKE DHE BUXHET

Financat publike janë aktivitete, dukuri dhe marrëdhënie të lidhura me mbledhjen, shpërndarjen, shpenzimin dhe menaxhimin me mjetet financiare nga ana e shtetit dhe organeve, institucioneve shtetërore, me qëllim të plotësimit të nevojave të përgjithshme dhe të përbashkëta.

Financat publike përfshijnë dy fusha kryesore - të hyrat publike dhe të dalat publike (shpenzimet publike), të cilat lidhen në një sistem racional dhe koherent, përmes formave dhe instrumenteve të posaçme të financimit: buxhetit, fondeve publike, planeve financiare, dhe të ngjajshme. Metodet, gjegjësisht "instrumentet" të cilat shfrytëzohen nga "dora publike" për realizimin e pjesës më të madhe të të hyrave të saj bazohet në detyrim, në "imperiumin" e pushtetit dhe interesit të arsyeshëm publik (shoqëror). Financat publike nuk cilësohen me kriteret tregtare, gjatë formimit ose shpenzimit të të hyrave publike. Forca shtytëse e të dalave publike është baza materiale e shtetit, dhe qëllimet e posaçme të politikës ekonomike, fiskale dhe sociale.

Duke e pasur parasysh faktin se nga njëra anë të hyrat publike kryesisht formohen nga baza materiale e shoqërisë, e cila në një mënyrë krijohet nga secili qytetar i shoqërisë, dhe nga ana tjetër se të dalat publike ndikojnë në treguesit ekonomikë dhe socialë të shoqërisë, dhe se duhet të jenë të arsyeshëm për interesin shoqëror, imponohet nevoja serioze për vullnetin e ndërgjegjshëm për financat publike tek të gjithë qytetarët e shoqërisë, dhe në veçanti ndërgjegjja për buxhetin e shtetit, si instrumenti më i rëndësishëm i financimit publik.

Në përgjithësi, buxheti¹ është pasqyrë sistematike e të gjitha të hyrave dhe të dalave të cilat shteti i realizon gjatë një periudhe të planifikuar, gjegjësisht gjatë vitit buxhetor. E drejta financiare e shtetit përbëhet nga grupi i normave me të cilat rregullohen marrëdhëniet mes organeve shtetërore të obliguara për parashikimin, realizimin dhe shfrytëzimin e mjeteve publike. E drejta buxhetore i shpreh të gjitha aktet të cilat janë bazë për rregullimin e procedurës për miratimin, realizimin dhe kontrollimin e të gjitha rrjedhave buxhetore.

Cilësitë e rëndësishme të buxhetit janë:

1. Buxheti miratohet nga Kuvendi në formë të ligjit.

¹ Në literaturën financiare haset mendimi se emri i buxhetit rrjedh nga fjala e vjetër e gjuhës frënge „bougette”, që e nënkupton trastën e vogël të lëkurës, në të cilën ministri i financave i ka mbajtur aktet e diskutimit parlamentar për diskutimin dhe miratimin e projektit për financimin e nevojave të caktuara të përbashkëta, publike dhe shtetërore. Së këndejmi, fjala sajohet nga terminologjia financiare angleze, ku ministri i financave në procedurën parlamentare "ka mbajtur fjalim buxhetor" para Odës së poshtme, me propozim të caktuar të llogaritjes të të hyrave dhe dalave, të cilat zakonisht i ka ruajtur në një trastë të lëkurës. Hapja e trastës dhe diskutimit është quajtur "hapja e buxhetit".

2. Buxheti është ligj sipas formës, por jo edhe sipas përmbajtjes, për shkak se nuk përmban rregulla dhe obligime si ligjet tjera.
3. Në Buxhet parashikohen të hyrat dhe të dalat për vitin buxhetor, dhe zakonisht ai miratohet për një vit kalendarik.
4. Buxheti duhet të aprovohet para fillimit të vitit buxhetor. Në të kundërtën, në qoftë se buxheti për cilëndo arsye nuk miratohet në kohën e duhur, duhet të realizohet financimi i përkohshëm, në pajtim me rregullativën ligjore.
5. Në buxhet planifikohen të hyrat dhe të dalat, të cilat shprehen në njësi të parasë. Të hyrat dhe të dalat e realizuara të buxhetit nuk duhet patjetër të përputhen me planifikimet, dhe kjo ndodh në pjesën më të madhe të shteteve në botë.
6. Zakonisht, buxhetet përcillen me akte shoqëruese ligjore (p.sh. Ligji për realizimin e buxhetit).
7. Si që është cekur më lartë, buxheti është instrument financiar, përmes të cilit derdhet dhe shpërndahet pjesa më e madhe e prodhimit shoqëror.

Me buxhetin lidhen dy lloje të parimeve: Parimet statistikore dhe dinamike.

Parimet statistikore aplikohen në fazën e rregullt të buxhetit, dhe si objekt e kanë përmbajtjen e tij materiale, kurse parimet dinamike lidhen me buxhetin në fazat e lëvizjes së tij, gjegjësisht hartimit, përcaktimit dhe realizimit, që do të thotë se si objekt e kanë anën e tij formale. Parimet statistikore janë: plotësia dhe realiteti, kurse dinamike janë: parimi i specializimit, baraspeshës, afateve kohore dhe publicitetit.

Parimi i plotësisë parasheh që buxheti t'i përfshijë të gjitha të hyrat dhe të dalat e shtetit në një vit buxhetor.

Parimi i realitetit parasheh që të hyrat dhe të dalat të planifikohen në mënyrë në të cilën nuk do të ketë dallime mes planifikimeve dhe realizimit. Kjo do të thotë se parashikimet duhet të jenë reale, për shkak se vetëm në këtë mënyrë do të sigurohet bilanci i baraspeshuar. Në qoftë se të hyrat dhe të dalat planifikohen me përpikshmëri, buxheti nuk do të ketë as suficit, dhe as deficit.

Parimi i specializimit siguron specializim të buxhetit, me çka sigurohet disiplina buxhetore. Specializimi cilësor përbëhet nga aprovimi të cilin e jep Kuvendi për realizuesit e buxhetit, me qëllim që t'i mbledhin të dhënat gjatë periudhës buxhetore, dhe t'i shfrytëzojnë ato për nevojat e parashikuara shtetërore, në bazë të një ose më tepër specifikimeve detajore. Në këtë mënyrë, nga njëra në përcaktohen obligimet e organeve shtetërore në aspekt të të hyrave publike, dhe nga ana tjetër përcaktohen të drejtat e organeve në aspekt të të dalave shtetërore.

Parimi i baraspeshës parasheh baraspeshën e buxhetit. Por, është fakt që pjesa më e madhe e shteteve në botë kanë deficit buxhetor. Lidhur me aplikimin e këtij parimi, ekzistojnë doktrina të ndryshme në literaturën ekonomike, ndonëse ato nuk përfshihen në këtë udhëzues.

Parimi i afateve - buxheti është një planifikues i gjatë të cilin duhet ta respektojnë të gjitha organet. Në Ligjin për buxhet ceket se buxheti miratohet për një vit, por për planifikimin, hartimin, shqyrtimin, votimin, realizimin dhe kontrollimin e tij

parashihen afate, të cilat duhet të respektohen. Kjo imponohet si parakusht i nevojshëm për zhvillimin adekuat të afateve buxhetore.


Buxheti nuk guxon të jetë i fshehtë. *Parimi i publicitetit* parasheh që buxheti është akt publik. Opinioni publik duhet të njihet me buxhetin në momentin kur ai i propozohet organit ligjvënës për miratim (Kuvendit/ Parlamentit), si dhe kur pranohet përfundimisht. Përveç kësaj, opinioni publik duhet të informohet për mënyrën në të cilën buxheti realizohet gjatë vitit.

KAPITULLI II: BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Pasi që kemi definuar buxhetin dhe jemi njohtuar me cilësitë dhe parimet themelore të buxhetit, mund ta shqyrtojmë Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

Buxheti është plan vjetor për financimin e funksioneve dhe obligimeve të Republikës së Maqedonisë, njësite të vetëqeverisjes lokale dhe fondeve, dhe përbëhet nga vlerësimi vjetor i të hyrave dhe shpenzimeve sipas dedikimit. Me vlerësimin vjetor nënkuptohet viti fiskal prej 12 mujave, i cili fillon më 1 janar, dhe përfundin më 31 dhjetor të secilit vit kalendarik, dhe vlen vetëm për vitin fiskal për të cilin është miratuar. Kjo do të thotë se viti buxhetor në Maqedoni korrespondon me vitin kalendarik.

Kur flitet për Buxhetin e Maqedonisë, mendohet në mjetet e njësive shfrytëzuese të Buxhetit, buxheteve të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe Qytetit të Shkupit, dhe buxhetit të fondeve.



Organogrami 1. Struktura e Buxhetit të Maqedonisë

Nga Organogrami 1 shohim se si shfrytësues të Buxhetit të Republikës paraqiten:

- *shfrytëzuesit* e mjeteve të buxhetit, dhe
- *njësitë shfrytëzuese* të mjeteve të buxhetit të cilat financohen nga shfrytëzuesit e mjeteve të buxhetit.

Shfrytëzuesit e mjeteve të Buxhetit të Republikës i takojnë pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Nga ana tjetër, *njësitë shfrytëzuese* të mjeteve të Buxhetit të Republikës janë institucionet e fushës së arsimit dhe shkencës, kulturës, mbrojtjes së fëmijëve, mbrojtjes sociale, gjyqësisë dhe prokurorisë, të cilat financohen përmes shfrytësuesit të Buxhetit të Republikës të fushës gjegjëse. Për shembull, Ministria për arsim është shfrytëzuese e mjeteve buxhetore, nga ana tjetër, univerzitetet shtetërore janë njësi shfrytëzuese të mjeteve buxhetore, dhe financohen përmes Buxhetit të Ministrisë për arsim.

Përveç mjeteve të shfrytëzuesve dhe njësive shfrytëzuese të buxhetit, Buxheti i Republikës përbëhet edhe nga mjetet e buxheteve të:

- Fondit për sigurim pensional dhe invalidor;
- Fondit për sigurim shëndetësor të Maqedonisë;
- Fondit për rrugë, dhe
- Agjencisë për punësim.

Në fund rradhitën buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale (jo sipas rëndësisë, por rradhitjes). Ata i hartojnë, propozojnë dhe miratojnë buxhetet e tyre në mënyrë të mëvetësishme, në pajtim me instruksionet e dhëna nga ministri i financave.

Të gjitha tre llojet e buxheteve kalojnë në procedura tejet të ngjajshme të hartimit, miratimit dhe realizimit.

Për realizimin e mjeteve financiare të Buxhetit të Republikës, gjegjësisht mjeteve financiare të shfrytëzuesve dhe njësive shfrytëzuese të mjeteve buxhetore, Ministria e financave e Republikës së Maqedonisë hap dhe mirëmban llogari të thesarit. Llogaria e thesarit është llogari për arkëtim të centralizuar të të hyrave dhe realizimit të centralizuar të të dalave të Buxhetit. Në kuadër të llogarisë së thesarit gjenden edhe llogaritë e fondeve.

1. Buxheti i Republikës

Buxheti i Republikës i paraqet të hyrat dhe të dalat (shpenzimet) e planifikuara të cilat shteti planifikon t'i realizojë, në pajtim me dispozitat ligjore, në një vit fiskal, i cili në Maqedoni përputhet me vitin kalendarik. Buxheti miratohet nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Propozimi për Buxhetin e Republikës së Maqedonisë përcaktohet nga Qeveria, e cila ia dorëzon Kuvendit për miratim, jo më vonë se në mesin e muajit nëntor.

Buxheti hartohet në bazë të politikës makroekonomike dhe proeksionit të agregateve makroekonomike për vitin për të cilin propozohet buxheti. Agregatat makroekonomike janë: shuma e prodhimit bruto vendor, shkalla e inflacionit, kursi devizor, shuma e eksportit dhe importit, shuma e bilancit tregtar, bilanci i llogarisë rrjedhëse, shuma e rezervave devizore, shuma e borxhit të jashtëm dhe vlera e investimeve të huaja direkte.

Ministri i financave i Republikës së Maqedonisë është përgjegjës për përgatitjen e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, dhe për parashtrimin e tij tek Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Ai gjithashtu i propozon edhe direktivat dhe synimet e politikës buxhetore, si dhe kategoritë kryesore për të hyrat dhe shpenzimet e vlerësuara për vitin vijues buxhetor.

1.1 Aspektet ekonomike të politikës buxhetore

Në politikën buxhetore realizohet sinteza e shfrytëzimit të të hyrave dhe dalave publike, si instrumente të cilat në kombinime të caktuara mund të kontribuojnë në

mënyrë efikase në realizimin e qëllimeve të politikës ekonomike në vend. Inkurajimi i sipërmarrësisë ose stimulimi i zhvillimit ekonomik, dedikimi i një pjese të të hyrave për fondet sociale ose investimi në infrastrukturë.

Qëllimet e politikës buxhetore mund të jenë:

- alokimi i resurseve (shpërndarja e burimeve)
- rishpërndarja
- stabilizimi ekonomik

Alokimi i resurseve: Ndonëse funksioni alokues i resurseve në shoqëri synon t'i nënshtrohet mekanizmave të tregut, imponohet nevoja që në situata të caktuara, për shkak të mangësive të konkurrencës dhe tregut të lirë, ndikimit të monopoleve dhe interesave tjerë shtetërorë (p.sh. stimulimi i investimeve të huaja), shteti të ndërmerr veprime përmirësuese në drejtim të mënjanimin të pasojave të padëshirueshme të mospërsosurisë së tregut. Kjo realizohet përmes politikës të të hyrave dhe dalave.

Për shembull, shteti lejon përjashtime tatimore të sektoreve të caktuara, me qëllim të stimulimit të zhvillimit të tyre, për shkak se kjo është në interes të shoqërisë. Ose përmes politikës së shpenzimeve, shteti investon në sektoret joatraktive për sektorin privat, por të cilat kanë rëndësi të madhe, për shkak se ofrojnë shërbime me interes publik, ose janë infrastrukturë.

Rishpërndarja: Me të hyrat dhe dalat buxhetore bëhet rishpërndarja me qëllim të realizimit të qëllimeve shoqërore, ku mjetet e njëres kategori kalojnë në pronësinë e kategorisë tjetër të personave fizikë dhe juridikë. Me rishpërndarjen faktikisht bëhet rishpërndarja në favor të kategorive të caktuara të qytetarëve ose ndërmarrjeve (në forma të ndryshme të ndihmës sociale, subvencioneve, etj).

Stabilizimi ekonomik: Të dalat publike janë një pjesë e bruto-prodhimit vendor, gjegjësisht:

$$Y = C + I + G$$

Ku **Y** është bruto-prodhimi vendor

C shpenzimet publike

I shpenzimet investuese, dhe

G shpenzimet e shtetit, gjegjësisht të dalat publike.

Kjo do të thotë se secili ndryshim në të hyrat publike ndikon në shpenzimin e plotë agregat në shtet. Nga ana tjetër, me tatimimin ndikohet në disponueshmërinë me fitimin e ndërmarrjeve dhe individëve. Së këndejmi, me kombinimin e drejtë të tatimit dhe shpenzimeve publike, mund të ndikohet në nivelin e shfrytëzimit të resurseve të ekonomisë, dhe raportit ndërmjet ofertës globale dhe kërkesës në ekonomi, gjegjësisht stabilizimit ekonomik të vendit.

1.2 Kontrolli buxhetor

Tashmë kemi parë se organe të ndryshme shtetërore nga njëra anë e aprovojnë dhe realizojnë buxhetin, kurse nga ana tjetër, në realizimin e buxhetit nuk merr pjesë vetëm një person, por shumë më tepër. Tërë kjo jep mundësi për lëvizje kundërthënëse gjatë realizimit të buxhetit, të cilat paraqiten në format e ndryshimit të dedikimit të mjeteve, shpenzimit joracional, menaxhimit të keq, etj. Për eliminimin e këtyre mundësive, gjegjësisht për minimizimin e tyre dhe për sigurimin e realizimit të drejtë të buxhetit, realizohet kontrolli mbi realizimin e buxhetit.

Qëllimi i kontrollit të buxhetit është që buxheti të realizohet në mënyrën e aprovuar nga Kuvendi i Maqedonisë. Kjo do të thotë se detyrat themelore të kontrollit janë:

- arkëtimi i të hyrave buxhetore dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore të jenë në pajtim me dispozitat e vlefshme ligjore;
- realizimi i buxhetit t'i përgjigjet kërkesave të politikës së shëndoshë financiare.

Do të thotë se detyra e parë e qëllimit të kontrollit buxhetor e parasheh respektimin e kujdesshëm të dispozitave aktuale, kurse tjetra kërkon mbikëqyrje të organeve të cilat e realizojnë buxhetin.

Masa e kontrollit buxhetor është e madhe dhe e komplikuar, dhe kjo e imponon nevojën e planifikimit të mirë dhe rregullimit të drejtë organizativ.

Kontrollimi buxhetor realizohet si:

- kontrollë parandaluese - kontrollimi i cili duhet të kryhet nga të gjithë shfrytëzuesit dhe njësitë shfrytëzuese të buxhetit, gjatë tërë vitit fiskal, dhe
- kontrollë vijuese - kontrollimi (revizioni) i cili kryhet nga Enti shtetëror për revizion, plotësisht dhe në mënyrë të pavarur, pas përfundimit të realizimit të buxhetit, si dhe kontrolli i cili kryhet nga njësitë e brendshme për revizion të brendshëm, në suazat e vetë shfrytëzuesve dhe njësive shfrytëzuese të buxhetit.

Por, në kontrollimin e realizimit të buxhetit nuk mund të anashkalohet edhe roli i tërthortë i qytetarëve, gjegjësisht obliguesve tatimorë. Për të marrur pjesë në kontrollimin buxhetor, ata duhet të informohen për mënyrën në të cilën shpenzohen mjetet buxhetore. Shpenzimi i padrejtë dhe i gabuar i mjeteve buxhetore i nënshtrohet sanksioneve të parashikuara me dispozitat ligjore, që e imponon obligimin e paraqitjes së shfrytëzimeve të gabueshme tek organet kompetente të shtetit.

1.3 Menaxhimi me mjetet buxhetore

Për menaxhimin me mjetet financiare të Buxhetit të Republikës, në Ministrinë për financa hapet thesari i cili i kryen veprimet në vijim:

- menaxhon me shpenzimet e Buxhetit të Republikës;
- mban evidencë për arkëtimin e të hyrave në Buxhetin e Republikës;

- mban evidencë për arkëtimin e të hyrave të njërive të vetëqeverisjes lokale, shpërndarjen dhe kontrollimin e tyre;
- i evidenton të gjitha transaksionet e të hyrave dhe shpenzimeve të Buxhetit të Republikës, fondeve dhe njërive të vetëqeverisjes lokale në Librin kryesor të thesarit, gjegjësisht në bazën e të vetme të të dhënave të thesarit;
- mban evidencë për obligimet e ndërmarra nga shfrytësuesit dhe njësitë shfrytëzuese të mjeteve të Buxhetit;
- i lajmëron shfrytësuesit dhe njësitë shfrytëzuese të mjeteve të Buxhetit, fondet dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale për qarkullimin dhe gjendjen në llogaritë e tyre;
- mban kontabilitet buxhetor për të hyrat dhe shpenzimet e Buxhetit të Republikës;
- mban evidencë për pagesën e borxheve dhe garancive të Republikës së Maqedonisë;
- mban regjistër të shfrytësuesve dhe njërive shfrytëzuese të mjeteve të Buxhetit;
- mban evidencë për obligimet e paplotësuara të shfrytësuesve dhe njërive shfrytëzuese të mjeteve të Buxhetit;
- përgatitë proeksione rrjedhëse për të hyrat dhe shpenzimet e Buxhetit të Republikës;
- përgatitë raport për arkëtimin e të hyrave dhe realizimin e shpenzimeve.

Përderisa për menaxhimin me mjetet financiare të Buxhetit të Republikës themelohet thasari në Ministrinë e financave, për realizimin e mjeteve financiare të Buxhetit, Ministria e financave hap dhe menaxhon llogari të thesarit tek bartësi i qarkullimit pagesor në Maqedoni, gjegjësisht Banka Popullore.

Përmes llogarisë së thesarit bëhet arkëtimi i centralizuar i të hyrave publike, dhe pagesa e centralizuar e të gjitha shpenzimeve të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë. Kjo do të thotë se në kuadër të llogarisë së thesarit, të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë kanë llogari të tyre, të disa llojeve (llogaria buxhetore, llogaria për të hyrat e mbledhura nga organet, llogaria për të hyrat vetanake, llogaria për donacione, llogaria për borxhe), përmes të cilave realizohen transaksionet. Llogaria e thesarit menaxhohet nga Ministria e financave - thesarit. Në praktikë, thesari është "kuazi-bankë" për shfrytëzuesit buxhetorë, me mbi 3.000 llogari të shfrytëzuesve buxhetorë, llogari për arkëtimin e të hyrave publike dhe llogari tjera të dedikuara të shtetit, me çka nënkuptohet arkëtimi i drejtëpërdrejtë i të hyrave publike dhe realizimi i centralizuar i shpenzimeve.

Në suazat e llogarisë së thesarit gjenden edhe llogaritë e fondeve jashtëbuxhetore (Fondi për sigurim pensional dhe invalidor, Fondi për sigurim shëndetësor, Fondi për rrugë magjistrale dhe rajonale dhe Agjencia për punësim).

Kjo mënyrë e organizimit të punës së thesarit, në literaturë dhe nivel ndërkombëtar njihet si koncept i "Llogarisë së vetme të thesarit".

1.4 Baraspesha buxhetore

Një nga parimet dinamike të buxhetit, si që kemi cekur paraprakisht, është edhe parimi i baraspeshës, i cili e imponon nevojën e baraspeshimit të të hyrave dhe të dalave publike të buxhetit. Kjo do të thotë se duhet të shpenzohet shumta e njëjtë e të hollave të mbledhura nga buxheti. Në qoftë se buxheti nuk është në baraspeshim, atëherë ai është në suficit, ose më së shpeshi në deficit.

Suficiti buxhetor paraqitet kur dallimi mes të hyrave të planifikuara (përveç borxheve të marrura) dhe shpenzimeve të planifikuara është pozitiv, gjegjësisht ka më tepër të hyra se shpenzime. Deficiti buxhetor paraqitet kur dallimi mes të hyrave të planifikuara (përveç borxheve të marrura) dhe shpenzimeve të planifikuara është negativ, gjegjësisht shpenzimet janë më të mëdha se të hyrat.

Buxheti i Republikës së Maqedonisë, që nga mëvetësimi i Republikës (1991) cilësohet kryesisht me deficit buxhetor, me disa përjashtime kur është vërejtur suficiti buxhetor.

Deficiti i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë financohet me marrjen e borxheve nga vendi dhe jashtë, gjegjësisht me lëshimin e bonove ose obligacioneve shtetërore.

Në rast të dallimit kohor mes periudhës kur derdhen të hyrat dhe kur realizohen shpenzimet e Buxhetit të Republikës, ky dallim tejkalohet me lëshimin e bonove shtetërore nga Republika e Maqedonisë.

1.5 Prej çka përbëhet Buxheti i Republikës?

Buxheti është rezultat i procesit buxhetor, i cili është një përbërje komplekse e shumë aktiviteteve dhe marrëdhënieve mes të gjitha institucioneve shtetërore të cilat i arkëtojnë dhe shpenzojnë mjetet publike. Procesi i buxhetit përbëhet prej tre fazave: përgatitja e buxhetit, miratimi i buxhetit dhe realizimi i buxhetit. Në kapitujt vijues do të trajtohen të gjitha tre fazat në mënyrë të detajuar.

Në këtë kapitull duhet të kemi parasysh se jemi duke e shqyrtuar strukturën e buxhetit gjatë realizimit të tij. Konkretisht, gjatë realizimit të buxhetit, Buxheti përbëhet nga:

- Buxheti qendror - i financuar nga të *hyrat burimore*;
- Buxheti i shfrytëzuesve - i financuar nga të *hyrat buxhetore të arkëtuara nga shfrytëzuesit*;
- Buxheti i aktiviteteve të vetëfinancuara - i financuar nga të *hyrat e realizuara nga aktivitetet plotësuese të shfrytëzuesve buxhetore*;
- Buxheti i donacioneve - i financuar nga të *hyrat e realizuara nga donacionet*, dhe
- Buxheti i kredive - i financuar nga të *hyrat në bazë të kredive*.

1.5.1 Buxheti qendror i Republikës së Maqedonisë

1.5.1.1 Të hyrat e Buxhetit qendror

Sipas Ligjit për buxhete, të hyrat e Buxhetit qendror sigurohen nga:

a) Tatimet

- tatimi mbi fitim;
- tatimi mbi të ardhurat personale;
- tatimi i vlerës së shtuar dhe akcizat, dhe
- tatimet tjera të përcaktuara me ligj.

b) Doganat dhe detyrimet tjera (tatimet në këmbimet dhe transaksionet ndërkombëtare)

c) Taksat

- taksat administrative;
- taksat gjyqësore.

ç) Të hyrat jotatimore

- të hyrat nga dividenda e ndërmarrjeve;
- gjobitjet;
- të hyrat nga kamatat e borxheve të dhëna;
- të hyrat nga kamatat e mjeteve të deponuara;
- të hyrat në bazë të shpenzimeve të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, dhe
- detyrimet tjera publike të caktuara me ligj.

d) Të hyrat nga donacionet prej vendit dhe jashtë (në mallra dhe të holla)

dh) Të hyrat e dhëna nga Buxheti i Republikës, në baza të ndryshme në pajtim me ligjin.

Përveç të hyrave të lartëcekura, si të hyra të Buxhetit të Republikës konsiderohen edhe të hyrat në bazë të marrjes së borxheve nga vendi dhe jashtë, me të cilat financohet deficitin buxhetor.

Të hyrat e lartëcekura të buxhetit mund të kategorizohen në tre grupe:

- të hyrat rrjedhëse - të hyrat tatimore dhe jotatimore,
- të hyrat kapitale, dhe
- të hyrat nga donacionet dhe borxhet nga vendi dhe jashtë.

Të hyrat rrjedhëse janë të hyrat e realizuara në periudhën prej maksimum një viti. Të hyrat rrjedhëse ndahen në:

- *të hyrat tatimore*: tatimi i vlerës së shtuar, tatimi mbi të ardhurat personale, tatimi mbi fitimin, akcizat, doganat, tatimet komunale, dhe
- *të hyrat jotatimore*: ose të hyrat të cilat nuk rrjedhin nga tatimet: të hyrat prej dividendave, gjobave, kamatave, etj.

Drejtoria e të hyrave publike është institucioni kompetent për arkëtimin e të gjitha të hyrave tatimore, me përjashtim të doganave për të cilat kompetente është Drejtoria doganore.

Të hyrat kapitale janë të hyrat e realizuara nga shitja e tokës shtetërore, rezervave të mallrave, dhe shitja e objekteve ndërtimore. Këto të hyra nuk kanë pjesëmarrje të konsiderueshme në të hyrat e përgjithshme.

Donacionet janë të gjitha pagesat e pakthyeshme, gjegjësisht mjetet e fituara nga institucionet tjera shtetërore, ndërkombëtare ose rajonale, të cilat nuk duhet të kthehen. Zakonisht këto janë mjete nga programet ose projektet e ndryshme me interes publik.

Në Tabelën 1 paraqiten të hyrat për vitin 2004 dhe 2005, të ndara sipas llojeve të ndryshme. Pjesëmarrje më të madhe kanë të hyrat tatimore, pastaj të hyrat jotatimore, dhe në fund të hyrat e huazimit nga vendet e huaja.

Llojet e të hyrave	Gjithsej të hyra për 2004	Gjithsej të hyra për 2005
Të hyrat tatimore	51.862.130	52.638.030
Të hyrat jotatimore	13.466.051	11.275.748
Të hyrat kapitale	4.116.702	4.166.610
Transferet dhe donacionet	4.308.178	4.952.639
Borxhi i brendshëm	2.000.000	2.500.000
Borxhi i jashtëm	5.069.632	4.103.450
Të hyrat nga pagesa e borxheve	9.911	0
GJITHSEJ:	80.832.604	79.636.477

Tabela 1: Llojet e të hyrave në 2004 dhe 2005

Të hyrat tatimore për vitin 2005 janë projektuar në nivelin prej 52.638 milionë denarëve. Arkëtimi më i madh i të hyrave pritet të realizohet nga tatimi i vlerës së shtuar dhe akcizave, në lartësi prej 70% të të gjitha të hyrave tatimore.

Njëherazi, pritjet e këtij viti buxhetor bazohen në përmirësimin e ekonomisë në vitin 2005, me çka ka pasur edhe rritje të konsiderueshme të arkëtimit të të hyrave, të pothuajse të gjitha llojeve të tatimit.

(në mijëra denarë)

Llojet e të hyrave tatimore	Të hyrat buxhetore për 2005	Të hyrat e institucioneve buxhetore	Gjithsej të hyra tatimore për 2005
Tatimi mbi të ardhura, fitim dhe fitime kapitale	10.502.000	188.240	10.690.240
Tatimet vendase për mallra/shërbime	36.588.000	16.260	36.604.260
Tatimi nga tregtia ndërkombëtare dhe transaksionet (doganat dhe taksat)	4.731.000	112.530	4.843.530
Taksat për kryerjen e veprimtarive ose lejet	500.000	0	500.000
GJITHSEJ:	52.321.000	317.030	52.638.030

Tabela 2: Të hyrat tatimore të buxhetit qendror për vitin 2005

Të hyrat jotatimore janë të hyra nga taksat administrative dhe gjyqësore, të hyrat nga arkëtimi i detyrimeve në bazë të sanimit të bankave, të hyrat në bazë të kamatave për mjetet e deponuara në BPRM, të hyrat nga dividendat e aksioneve të Qeverisë në SHA Telekom i Maqedonisë, etj. Për vitin 2005 planifikohen të hyra jotatimore në vlerë prej 5.243 milionë denarëve, gjegjësisht për 6,4% më pak në krahasim me vitin 2004.

Të hyrat kapitale kryesisht arkëtohen nga shitja e pronës shoqërore (banesat dhe toka ndërtimore). Për vitin 2005 planifikohet shuma e njëjtë e këtyre të hyrave si edhe në vitin 2004, gjegjësisht në vlerë prej 4.164 milionë denarëve.

Të hyrat nga huazimi i brendshëm dhe i jashtëm për vitin 2005 janë planifikuar në vlerë prej 5.136 milionë denarëve.

Të hyrat nga kreditë realizohen në bazë të miratimit paraprak të ligjit nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për marrjen e borxhit, ku përcaktohen qëllimet e caktuara, si për shembull investimet kapitale ose zhvillimi i ndonjë sektori specifik të ekonomisë. Të hyrat e planifikuara për vitin 2005 janë në shumë prej 1.583 milionë denarëve, që është për 30% më pak se në vitin 2004.

Donacionet janë mjete të dhëna/ dhuruara pa kompensim, për dedikime të përcaktuara saktësisht. Me Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2005 planifikohet shuma prej 3.413 milionë denarëve, gjegjësisht për 32,6% më tepër se në vitin 2004.

Institucionet buxhetore mund të japin edhe shërbime tjera ose të kryejnë aktivitete për të cilat arkëtojnë kompensim adekuat. Këto shërbime sigurohen nga institucionet shtetërore, për shkak se nuk ofrohen nga sektori privat, ose për shkak se shteti i realizon me shpenzime dukshëm më të ulta. Të hyrat e realizuara në këtë bazë për vitin 2005 janë në vlerë prej 6.204 milionë denarëve, gjegjësisht për 22,5% më pak se në vitin 2004.

1.5.1.2 Të dalat (shpenzimet) e Buxhetit qendror

Në mënyrë analogjike si ndarja e të hyrave të përgjithshme, të dalat e përgjithshme nga Buxheti qendror ndahen në:

- shpenzime rrjedhëse (rroga, mëditje dhe kompensime, shpenzime për mallra dhe të tjera, transfere rrjedhëse dhe pagesa për kamatat);
- shpenzime kapitale (blerja e mjeteve kapitale dhe transfereve kapitale);
- dhënia e borxheve dhe mjeteve për blerjen e letrave me vlerë, dhe
- pagesa e pjesëve themelore të borxheve të marrura nga vendi dhe jashtë.

Edhe këtu e kemi rastin e njëjtë si te të hyrat rrjedhëse - pjesa më e madhe e shpenzimeve realizohen për të dalat rrjedhëse.

Të dalat (shpenzimet) rrjedhëse janë të gjitha shpenzimet të cilat ndodhin në periudhë jo më të gjatë se një vit.

Këtu bëjnë pjesë:

- shpenzimet për rrogat dhe kompensimet;
- shpenzimet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve;
- transferet;
- pagesat për kamatat, dhe
- garancitë.

Shpenzimet kapitale janë të dala të shtetit të cilat zakonisht realizohen për periudhë më të gjatë se një vit. Këtu hyjnë shpenzimet për investime, transferet kapitale për nevojat e institucioneve, ndërmarrjeve, qytetarëve, etj, transferet kapitale të institucioneve ndërkombëtare financiare, si dhe transferet për projektet e ndryshme.


(në mijëra denarë)						
Llojet e të dalave	Të dalat buxhetore të financuara nga të hyrat qendrore	Të dalat e financuara nga të hyrat e instituci. buxhetore	Të dalat nga donac.	Të dalat nga aktivitetet vetë-financuese	Të dalat nga borxhet	Gjithsej të dalat për 2005
Rrogat, mëditjet dhe kompensimet për të punësuarit	21.757.205	20.016	0	745.984	0	22.523.205
Të dalat rezerve dhe të padefinuara	190.000	0	0	194	0	190.194
Mallirat/ shërbimet	7.161.570	1.378.260	597.111	3.198.070	125.770	12.460.781
Transferet rrejedhore për fondet jobuxhetore	14.469.698	0	0	6	0	14.469.704
Transferet rrejedhore për njësitë e vetëqeverisjes lokale	812.550	0	17.397	12.109	0	842.056
Kamatat	2.499.000	0	0	8.002	52.000	2.559.002
Subvencion/ transfer	2.452.295	174.955	25.602	604.832	168.000	3.425.684
Beneficionet sociale	4.123.652	0	0	705	0	4.124.357
Të dalat kapitale	5.739.499	323.502	2.773.377	1.590.092	1.237.954	11.664.424
Pagesa e pj. themel.	7.333.000	0	0	44.070	0	7.377.070
GJITHSEJ:	66.538.469	1.896.733	3.413.487	6.204.064	1.583.724	79.636.477

Tabela 3: Të dalat e Buxhetit për vitin 2005

Të dalat e përgjithshme të Buxhetit qendror për vitin 2005 planifikohen në vlerë prej 79.636 milionë denarëve, që është zvogëlim minimal prej 1,5% në krahasim me të dalat e përgjithshme për vitin 2004. Arsyeja kryesore për këtë zvogëlim janë planet më të ulta të realizimit të të dalave, të financuara nga organet dhe të dalat e aktiviteteve të vetëfinancuara, të cilat në esencë janë të dala të financuara nga të hyrat vetanake të institucioneve buxhetore. Të dalat buxhetore shënojnë rritje minimale prej 1,3% në krahasim me vitin 2004.

Në Grafikon 2 mund të shihet raporti ndërmjet të dalave rrjedhëse dhe kapitale për vitet 2003-2005.

**Shpenzimet rrjedhëse dhe kapitale
(në mln denare)**




Grafiku 2: Shpenzimet rrjedhëse dhe kapitale për vitin 2003 -2005

Pjesa më e madhe e shpenzimeve rrjedhëse realizohet për rrogat dhe kompensimet e administratës shtetërore. Vijnë të dalat për transferet, ku hyjnë transferet e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor (FSPI), transferet për Entin për punësim, refugjatët, reformat strukturore, dhe reformën e administratës publike.

Vijnë shpenzimet për furnizimin me mallra dhe shërbime të nevojshme për organet shtetërore, më pas shpenzimet për kamatat e huazimeve të brendshme dhe të jashtme, dhe në fund shpenzimet tjera.

Te dalat rrjedhese ne 2005 (ne mln denare)



Grafiku 3: Vlera e të dalave rrjedhëse të caktuara nga Buxheti qendror për vitin 2005


Të dalat për rrogat, mëditjet, kompensimet janë planifikuar në shumë prej 22.523 milionë denarëve, që është rritje prej 1.7% në krahasim me vitin 2004. Ky nivel i planifikuar i rrogave e ngërthen në vete edhe efektin e dekompresimit të rrogave të nëpunësve shtetërorë (rreth 350 milionë denarë), si dhe efektin e dymbëdhjetë rrogave mujore të personave të punësuar gjatë vitit 2004, në bazë të përfaqësimit të barabartë të pjesëtarëve të bashkësive tjera etnike. Gjatë vitit 2005 në shumën e rrogave nuk janë planifikuar mjete plotësuese për punësime të reja.

Pjesa më e madhe e peshës së konsolidimit fiskal në vitin 2005 do të bartet nga të dalat diskrecionale, kryesisht të dalat për mallra dhe shërbime.

Transferet rrjedhëse për vitin 2005 janë projektuar në vlerë prej 22.862 milionë denarëve, që është zvogëlim për 2,5% në krahasim me vitin 2004. Në kuadër të këtyre të dalave parashihen edhe mjete për realizimin e procesit të decentralizimit, gjegjësisht zbatimi i dispozitave të Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale në gjysmën e dytë të vitit.


Transferi i përgjithshëm në bazë të reformës së administratës publike në vitin 2005 planifikohet në vlerë prej 657 milionë denarëve, gjegjësisht 13,7% më tepër se në vitin 2004. Kjo rritje është kryesisht rezultat i realizimit të reformave në armatë, në pajtim me ndryshimet e Ligjit për shërbim në ARM.

Te dalat per reformimin e administrates publike



Grafiku 4: Të dalat për reformën e administratës publike për periudhën 2000-2005

Pagesat për kamatën për vitin 2005 planifikohen në nivel më të lartë se viti 2004, gjegjësisht për 14,6% më tepër, si rezultat i detyrimeve të shtuara kamatore në bazë të bonove afatshkurtëre shtetërore (220 milionë denarë) dhe përfshirjes së detyrimeve kamatore ndaj UIC në emër të Hekurudhave të Maqedonisë.



Grafiku 5: Të dalat për kamatat e kredive vendase (kaltër) dhe të huaja (kuqe) për periudhën 2000-2005

Të dalat kapitale për vitin 2005 planifikohen në nivelin e vitit 2004 (me 0,7% zvogëlim) ku si prioritet caktohet realizimi i rregullt dhe me kohë i projekteve investuese. Të dalat kapitale për vitin 2005 planifikohen në shumë prej 11.664 milionë denarëve.

Në tabelën 4 paraqiten projektet kapitale të cilat do të realizohen në vitin 2005 nga ana e institucioneve buxhetore.

Ndarja nën programi		1.710.018	81.780	2.167.718	259.507	906.351
PËRSHKRIMI		Buxheti i përgjithsh. i të hyrave qendrore	Buxheti i përgjithsh. i të hyrave të instit. publike	Buxheti i dotacion. dhe donacion.	Buxheti i aktivitet. vetë-financuese	Buxheti i borxheve
Kuvendi i RM-së		35.000	0	0	0	0
2A	Rikonstruimi i ndërtesës së Kuvendit të RM-së	35.000	0	0	0	0
Shërbimi për punë e përgjithshme dhe përbashkëta të Qeverisë së RM-së		180.000	0	0	0	0
1A	Rikonstruimi i ndërtesave të organeve qeveritare	180.000	0	0	0	0
Ministria për mbrojtje		61.000	37.600	0	0	0
5A	Ndërtimi i objekteve për mbrojtje	30.000	0	0	0	0
5B	Rikonstruimi i objekteve për mbrojtje	31.000	37.600	0	0	0
Ministria për punë të brendshme		52.000	0	0	2.250	0
1A	Rikonstruimi dhe pajisja e ndërtesave	0	0	0	2.250	0
2A	Ndërtimi i ndërtesave	18.300	0	0	0	0
2B	Rikonstruimi dhe pajisja e ndërtesave	33.700	0	0	0	0
Ministria për drejtësi		92.000	0	0	0	0
1A	Rikonstruimi dhe pajisja e njësisve rajonale dhe zyrave lokale	20.000	0	0	0	0
1B	Rikonstruimi dhe pajisja e prokurorive publike	10.000	0	0	0	0
2A	Ndërtimi, rikonstruimi dhe pajisja e enteve ndëshkuese-korrektive	52.000	0	0	0	0
GA	Reformimi i gjyqësorit	10.000	0	0	0	0
Ministria për punë të jashtme		0	35.000	0	0	0
2A	Blerja e ndërtesave për përfaqësi diplomatike konsulare	0	20.000	0	0	0

2B	Rikonstruimi i ndërtesave për përfaqësi diplomatike konsulare	0	15.000	0	0	0	0
Ministria për financa - funksionet e shtetit							
BA	Projekti për zhvillimin e komunave	27.560	0	50.200	0	158.657	
Drejtoria doganore e RM-së							
2A	Ndërtimi i objekteve	55.000	0	0	0	0	0
Drejtoria e të hyrave publike							
2A	Rikonstruimi i ndërtesave të Drejtorisë për të hyra publike	2.000	2.000	0	0	0	0
Ministria për ekonomi							
3A	Energjia e përtëritshme	35.728	0	21.335	0	0	0
3B	Kapacitetet ngrohëse termoenergjetike	0	0	12.550	0	0	0
3G	Hulumtimet themelore gjeodetike	10.728	0	8.785	0	0	0
3B	Sistemi informativ gjeologjik	20.000	0	0	0	0	0
Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor							
2A	Sanimi i pikave kritike ekologjike	5.000	0	0	0	0	0
4A	Rikonstruimi/ ndërtimi i stacioneve për filtrim	103.654	0	0	0	0	0
4B	Projekti Liqeni i Dojranit	36.654	0	0	0	0	0
Ministria për transport dhe lidhje							
3A	Ndërtimi i autostradës E-75	17.000	0	0	0	0	0
3B	Punët ndërtimore për sanimin e rrëshqitjeve	50.000	0	0	0	0	0
3V	Programi aksionar për avnacinin e komunave dhe ambientit jetësor	267.000	0	1.031.609	0	262.312	
3G	Furnizimi me ujë - Prilep	62.000	0	275.165	0	0	0
3D	Infrastruktura sociale 3	18.000	0	0	0	0	0
		153.000	0	258.801	0	262.312	
		31.000	0	30.900	0	0	0
		0	0	279.000	0	0	0


3E	Furnizimi me ujë në vendbanimet e rajonit të Shkupit	3.000	0	102.811	0	0
3Y	Ujësjetësit në NJVL	0	0	0	0	0
3I	Ndërtimi i kanalizimit në Shuto Orizare	0	0	36.666	0	0
3J	Ujrat e zi Prespë	0	0	15.450	0	0
3K	Furnizimi me ujë - Strugë	0	0	32.816	0	0
Drejtoria për komunikacion civil ajror						
2A	Ndërtimi i objekteve për kërkim dhe shpëtim	0	0	0	56.500	0
Drejtoria për telekomunikacione						
2A	Ndërtimi i qendrës për kontroll dhe matje	0	0	0	13.500	0
2B	Rikonstruimi i ndërtesave	0	0	0	500	0
Ministria për bujqësi, pylltari dhe ekonomizimin e ujrave		484.525	0	150.000	0	415.382
6A	Hidrosistemi Zletovica	70.500				
6B	Hidrosistemi Lisiçe	74.025	0	0	0	184.200
6G	Ujtiya e fushës së Vardarit të poshtëm	190.000	0	0	0	80.682
6V	Rihabilitimi dhe rikonstruimi i sitemit për furnizim me ujë	130.000	0	150.000	0	150.500
BB	Revitalizimi i fshatrave	20.000	0	0	0	0
Ministria për punë dhe politikë sociale						
1A	Rikonstruimi dhe pajisja e ndërtesave afariste	1.500	0	0	0	0
Mbrojtja shoqërore e fëmijëve						
2A	Rikonstruimi dhe pajisja e kopshteve për fëmijë	5.500	0	0	0	0
Mbrojtja sociale						
2A	Rikonstruimi dhe pajisja e objekteve për mbrojtje sociale	16.000	0	0	0	0

Ministria për arsim dhe shkencë						
2A	Ndërtimi i shkollave fillore	222.580	5.300	23.616	162.757	0
2B	Rikonstruimi i shkollave fillore	51.233	0	0	1.000	0
3A	Financimi i ndërtimit të shkollave Nikolla Shtejn dhe Zef Lush Marku	58.562	300	18.420	1.000	0
3B	Rikonstruimi i shkollave të mesme	55.000	0	0	0	0
4A	Ndërtimi i ndërtesave të fakulteteve	38.000	5.000	0	50.000	0
4B	Rikonstruimi i ndërtesave të fakulteteve	0	0	4.960	33.950	0
5A	Rikonstruimi i konvikteve të nxënësve	6.500	0	236	36.757	0
6A	Rikonstruimi i konvikteve të studentëve	7.285	0	0	15.000	0
8A	Rikonstruimi i ndërtesave të institucioneve shkencore	5.000	0	0	25.000	0
		1.000	0	0	50	0
Ministria për kulturë						
1A	Rikonstruimi i përmendoreve kulturore	18.000	0	40.000	0	70.000
Financimi i veprimtarive nga fusha e kulturës						
2A	Rikonstruimi i bibliotekave	18.000	0	40.000	70.000	0
3A	Rikonstruimi i ndërtesës së Vardar Filmit	29.855	0	850.958	0	0
4A	Ndërtimi i ndërtesave për teatër dhe dramë	1.000	0	0	0	0
4B	Rikonstruimi i ndërtesave për veprimtari skenare-artistike	0	0	850.958	0	0
5A	Rikonstruimi i Enteve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore	18.000	0	0	0	0
8A	Rikonstruimi i ndërtesave të muzeve	2.000	0	0	0	0
Ministria për shëndetësi						
4A	Rikonstruimi i objekteve për kontrollin e ushqimit	8.555	0	0	0	0
		1.200	0	0	0	0
Ministria për vetëqeverisje lokale						
		1.200	0	0	0	0
		17.000	0	0	0	0

1A	Ndërtimi i objekteve në njësitë e vetëqeverisjes lokale	17.000	0	0	0	0	0
Enti shtetëror për punë gjeodetike							
2A	Ndërtimi i ndërtesës afariste	0	0	0	0	24.000	0
Enti shtetëror statistikor							
1A	Rikonstruimi i ndërtesave të Entit shtetëror statistikor	968	1.880	0	0	24.000	0
2A	Rikonstruimi i ndërtesave të seksioneve rajonale	888	1.800	0	0	0	0
Arkivi shtetëror i RM-së							
1A	Rikonstruimi i ndërtesave të Arkivit	80	80	0	0	0	0
2A	Rikonstruimi i ndërtesave të Arkivit	948	0	0	0	0	0
Akademia e shkencave dhe arteve të Maqedonisë							
1A	Rikonstruimi i ndërtesës së	948	0	0	0	0	0
2A	Rikonstruimi i ndërtesës së ASHAM-it	1.000	0	0	0	0	0
2A	Rikonstruimi i ndërtesës së ASHAM-it	1.000	0	0	0	0	0

Tabela 4: Pasqyra e nënprogrameve për projekte kapitale-investuese të planifikuara me Buxhetin për 2005

Dhë në fund të kësaj pjese vijon shfaqja e të gjitha të dalave kapitale për periudhën 2003-2005.



Grafiku 6: Gjithsej të dalat kapitale për periudhën 2003-2005

1.5.2 Llojet e klasifikimit të të dalave

Të dalat mund të shqyrtohen nga aspekti organizativ, funksional, ekonomik dhe programor.

Klasifikimi organizativ tregon se si ndahen të dalat sipas organizatave, gjegjësisht shpenzimet të cilat secili shfrytëzues dhe njësi shfrytëzuese (p.sh. ministri, agjenci, qeveri, etj) i ka në disponueshmëri për shpenzim.


Klasifikimi funksional e tregon shumën e mjeteve të parashikuara për shpenzim, sipas funksioneve, gjegjësisht për çfarë qëllime duhet të shpenzohen mjetet (për shembull, për mbrojtje, shëndetësi, ekologji, mbrojtje sociale, etj).

Në Tabelën 5 dhe 7 paraqiten të dalat e buxhetit sipas klasifikimit funksional të të dalave, si dhe pjesëmarrja në përqindje e llojeve të caktuara të të dalave, për secilin funksion ndaras. Klasifikimi funksional i kategorizon të dalat sipas funksioneve themelore të cilat realizohen nga Qeveria, ku sigurohet pasqyrimi dhe transparenca më e madhe e punës së përgjithshme të Qeverisë.

Kategoria funksion.	PËRSHKRIMI	66.538.469	1.896.733	3.413.487	6.204.064	1.583.724
		Buxheti i përgjithsh. i të hyrave qendrore	Buxheti i përgjith. i të hyrave të instit. publike	Buxheti i dotacion. dhe donacion.	Buxheti i aktivitet. vetë-financ.	Buxheti i borxheve
701	Shërbimet e përgjithshme	5.876.040	697.002	104.716	919.778	146.000
702	Mbrojtja	5.895.026	114.500	0	0	0
703	Rendi publik	8.434.626	474.374	1.300	7.800	0
704	Punët ekonomike	15.921.278	288.945	496.700	1.254.899	843.539
705	Mbrojtja e ambientit jetësor	397.853	112.530	347.162	7.040	262.312
706	Banesat, zhvillimi i bashkësisë	863.486	25.820	843.675	145.000	1.982
707	Shëndetësia	631.063	54.060	59.041	150.000	80.000
708	Rekreimi, kultura, religjioni	1.447.521	46.405	1.096.366	176.943	90.662
709	Arsimi	9.913.308	82.697	463.027	3.456.301	57.730
710	Mbrojtja sociale	17.158.268	400	1.500	86.303	101.499

Tabela 5: Pasqyra e të dalave buxhetore sipas funksioneve të Qeverisë

Të dalat e përgjithshme të Buxhetit qendror planifikohen në vlerë prej 71.417 milionë denarëve, që është zvogëlim nominal prej 2,4% në krahasim me vitin 2004. Në këto korniza, të dalat aktuale marrin pjesë me 83,7% kurse të dalat kapitale me 16,3% në të dalat e përgjithshme buxhetore.



Grafiku 7: Të dalat buxhetore sipas funksioneve të Qeverisë


Klasifikimi ekonomik e nënkupton edhe klasifikimin e të dalave sipas llojit, gjegjësisht sipas dedikimit ekonomik të tyre (rrjedhëse, kapitale, etj). Dedikimin e fundit e kemi analizuar paraprakisht. Sa i përket klasifikimit programor, ky klasifikim i analizon të dalat sipas programeve të caktuara dhe pjesët e tyre përbërëse.

Sipas Ligjit për buxhete, klasifikimi i të hyrave dhe të dalave bëhet nga Ministri i financave.

1.6 Deficiti në krahasim me suficitin

Paraprakisht është cekur se parimi i barashpeshimit buxhetor parasheh që të dalat e përgjithshme të buxhetit të jenë të barabarta me të hyrat e përgjithshme. Në praktikë është e pamundur që shteti t'i realizojë të dalat me vlerë të barabartë me të hyrat e realizuara gjatë vitit fiskal. Buxheti më së shpeshi cilësohet me shpenzime më të larta publike, në krahasim me të hyrat publike, por është e mundur që të hyrat publike t'i tejkalojnë shpenzimet publike. Në rastin e parë themi se shteti ka realizuar deficit buxhetor, kurse në të dytin - suficit buxhetor.

Deficit/suficiti i buxhetit qendror
(% e BPV)



Grafiku 8: Deficiti dhe suficiti i Buxhetit qendror për periudhën kohore 1998-2005

Në Grafikon 8 paraqitet dallimi negativ, gjegjësisht pozitiv ndërmjet të hyrave dhe të dalave në Buxhetin e Maqedonisë për secilin vit (1998-2005). Gjatë tetë viteve të fundit, deficiti më i madh është shënuar në vitin 2001.

Deficiti buxhetor për vitin 2005 është projektuar në shumë prej 2.704 milionë denarëve, gjegjësisht 1% e bruto-prodhimit vendor.

Deficiti financohet, dhe ky financim në fakt e tregon shumën të cilën shteti duhet ta huazojë gjatë viti fiskal, gjegjësisht të ndajë mjete për pagesën e borxheve të skaduara. Burimet më të shpeshta të financimit të deficitit janë: të hyrat e privatizimit, donacionet e huaja, borxhet, emisioni i bonove shtetërore. Të hyrat e realizuara përmes privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore janë të njehershme, dhe paraqiten në buxhet vetëm në vitin kur privatizohet ndërmarrja e caktuar shtetërore. Këto të hyra janë afatshkurtëra, për shkak se me kalimin e kohës zvogëlohen çdoherë e më tepër, si rezultat i zvogëlimit të numrit të ndërmarrjeve shtetërore të cilat mund të privatizohen. Në rast të suficitit në buxhet, si në vitin 2000, teprica e të hyrave publike mbi shpenzimet publike shfrytëzohet për pagesën e borxheve të brendshme dhe jashtme.

Në vitin 2005, deficiti kryesisht financohet nga burimet e brendshme në shumë prej 6.584 milionë denarëve, në bazë të privatizimit, shfrytëzimit të mjeteve të deponuara në BPRM, të hyrat nga suksesioni dhe bonot afatshkurtëra shtetërore në neto-vlerë prej 2.500 milionë denarëve, si dhe burimet e jashtme, dhe tërheqjen e mjeteve sipas bazave në vijim:

- pjesa e dytë e donacionit nga Holanda (në vlerë prej 816 milionë denarëve),
- tërheqja e plotë e mjeteve të Borxhit për adaptimin programor dhe strukturor nga Banka Botërore (në vlerë prej 1.040 milionë denarëve), dhe

- kredia e Bankës evropiane për rikonstrum dhe zhvillim, për privatizimin e EEM-së (në vlerë prej 1.596 milionë denarëve).

Gjatë planifikimit të huazimit merret parasysysh afati i gjatë i pagesës së borxhit dhe shkalla e borxhit të jashtëm të Republikës së Maqedonisë. Në këtë mënyrë sigurohet financimi i rregullt dhe pa inflacion i shpenzimeve publike për vitin 2005.

1.7 Buxheti i fondeve jashtëbuxhetore

Gjatë shqyrtimit të Buxhetit të Republikës kemi cekur se ai përbëhet nga mjetet e shfrytëzuesve, dhe buxhetet e Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, Fondit për sigurim shëndetësor të Maqedonisë, Fondit për rrugë dhe Agjencisë për punësim të Republikës së Maqedonisë.


Të hyrat e buxheteve të fondeve sigurohen nga:

- kontributet;
- kompensimet;
- transferet nga buxhetet;
- të hyrat nga donacionet e pranuar nga vendi dhe jashtë (në mallra dhe të holla), dhe
- të hyrat tjera sipas bazave të ndryshme, në pajtim me Ligjin për buxhete.

Mungesa e përkohshme e të hyrave të buxheteve të fondeve gjatë vitit mbulohet përmes borxheve të marrura nga Buxheti i Maqedonisë.

Fondi për sigurimin pensional dhe invalidor

Pjesa më e madhe e të hyrave të Buxhetit të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor janë të hyrat në bazë të kontributeve nga rrogat, të hyrat nga Buxheti i Republikës, dhe në fund - të hyrat nga Agjencia për punësim, për sigurimin e të papunësuarve - shfrytëzues të asistencave në të holla. Pjesëmarrja në përqindje mund të shihet në Grafikon 9. Ndonëse jepet pasqyra vetëm për një vit, duhet të kemi parasysysh se struktura e të hyrave dhe raporti mes të hyrave të ndara mbetet i njëjtë, ndonëse pjesëmarrja individuale mund të ndryshojë gjatë viteve tjera.



Grafiku 9: Pjesëmarrja në përqindje e të hyrave të caktuara në të hyrat e përgjithshme të buxhetit të Fodnit për sigurim pensional dhe invalidor për vitin 2003.

Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e të dalave të përgjithshme shpenzohen për pagesën e pensioneve të shfrytëzuesve, ku pensionet e rregullta kanë pjesëmarrje më të madhe. Shumat sipas kategorive të ndara për vitet e caktuara mund të shihen në Tabelën 6. Njëherazi mund të shihen edhe raportet mes të hyrave dhe të dalave, gjegjësisht a realizohet suficit ose deficit gjatë viteve të ndryshme.

FONDI PËR SIGURIMIN PENSIONAL DHE INVALIDOR

(në mln. Denarë)

Lloji i të hyrave/ dalave	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Janar-Tetor
TË HYRAT	20,717	21,229	22,883	24,289	25,811	28,191	28,983	23,479
Të hyrat nga rogat	13,373	14,616	16,722	15,671	15,784	16,882	17,204	14,173
Të hyrat nga të ardhurat	239	311	311	331	283	307	383	320
Të hyrat nga Buxheti i Republikës	3,615	3,266	4,174	5,744	6,961	7,741	8,186	6,727
Të hyrat nga sektori privat	400	439	404	377	409	394	412	305
Të hyrat nga bujqit individualë	74	65	58	41	61	71	41	29
Të hyrat nga akcizat	691	632	504	716	658	677	661	653
Kontributet nga Enti për punësimin e të papunësuarve	961	868	1,101	1,128	1,404	1,536	1,719	1,304
Të hyrat tjera	122	45	74	73	29	65	57	50
Të hyrat nga dividenda dhe shifja e letrave me vlerë	619	245	68	209	192	42	21	18
Të hyrat në bazë të punësimeve të reja	419	541	167	0	0	0	0	0
Të hyrat e bartura nga viti i kaluar	201	201	0	0	0	476	0	0
TË DALAT	20,521	20,669	22,940	24,697	25,889	27,740	29,132	23,766
Pensionet	17,730	17,755	19,774	21,278	22,255	24,008	26,121	20,726
Pensionet e rregullta	16,912	16,977	18,948	19,041	19,952	21,667	22,824	19,281
Pensionet ushtarake	464	458	506	541	618	499	509	402
Pensionet bujqësore	364	321	321	297	262	234	217	151
Pagesa retroaktive e 8%	0	0	0	1,167	1,136	1,131	1,027	455

Pensionimi i parakohshëm sipas Ligjit të vitit 2000	0	0	0	112	103	121	88	66
Pensionimi i parakohshëm sipas Ligjit të vitit 2001	0	0	0	148	251	262	247	179
Pensionimi i parakohshëm sipas Ligjit të vitit 2004								63
Kompensimet për dëmtimet trupore	63	69	72	72	83	80	82	69
Kompensimet për sigurimin invalidor	95	95	94	91	76	98	97	89
Punësimi dhe vendosja e fëmijëve-invalidë në internat	15	13	12	7	9	6	6	4
Kontributet për mbrojtjen shëndetësore	2,321	2,450	2,872	2,806	2,934	3,184	3,349	2,651
Kompensimi për shërbimin profesional	133	132	141	153	165	172	170	128
Shpenzimet tjera	161	154	176	254	222	192	267	144
Mjetet kapitale	/	/	/	37	145	0	60	52
DALLIMI								
Deficiti/suficiti	196	560	-57	-408	-78	451	-149	-287

Tabela 6: Buxheti i Fondit për sigurim pensional dhe invalidor sipas viteve

Burimi: Të dhënat e brendshme të Ministrisë për financat

Vërejtje: Shuma për vitin 2005 e mbulon periudhën për dhjetë muajt e parë të vitit, deri në tetor 2005.

Fondi për sigurimin shëndetësor

Në strukturën e të hyrave të buxhetit të Fondit për sigurim shëndetësor, pjesëmarrje më të madhe kanë kontributet për sigurim shëndetësor. Kontributet e Fondit pensional janë në vendin e dytë të të hyrave të përgjithshme, kurse kontributet e paguara nga Agjencia për punësimin e të papunësuarve janë në vendin e tretë. Njëherazi, pjesëmarrje më të madhe në të dalat e Fondit për sigurim shëndetësor kanë shpenzimet ambulatore dhe për shërimin në spital. Shumat për secilën kategori të të hyrave dhe dalave për vitet e dhëna mund të shihen në Tabelën 7. Njëherazi mund të shihet edhe raporti ndërmjet të hyrave dhe të dalave, gjegjësisht suficitit dhe deficitit të realizuar në Buxhetin e fondit sipas viteve të dhëna.

FONDI PËR SIGURIMIN SHËNDETËSOR

(në mln. denarë)

Lloji i të hyrave/ dalave	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Janar-Tetor
TË HYRAT	11,087	12,068	12,790	12,295	13,656	14,698	14,886	12,036
Kontributet	6,736	7,363	7,745	7,528	7,823	8,418	8,762	7,279
Kontributet nga Fondi pensional	2,309	2,417	2,649	2,616	3,076	3,184	3,349	2,664
Kontributet nga Enti për punësim	1,037	1,350	1,941	1,554	1,763	1,849	1,998	1,717
Kontributet nga Ministria e punës	46	0	0	48	54	64	41	63
Të hyrat tjera	861	988	455	70	734	1,064	676	396
Të hyrat sipas kontratave për kartonat blu	109	0	0	0	0	0	0	36
Mjetet e Buxhetit të RM për mbrojtje të detyrueshme shëndetësore	/	/	/	168	111	29	60	2
Teprica e bartur nga viti i kaluar	0	0	0	313	96	91	1	0
TË DALAT	13,689	11,692	12,463	12,205	13,611	14,678	14,722	12,198
Shpenzimet për ambulancat	6,303	2,491	2,486	2,505	4,430	5,132	5,969	6,117
Shërbimi spitalor	4,702	5,482	5,737	5,919	4,929	5,038	5,098	4,591
Shpenzimet për programet	214	125	106	306	123	21	0	0
Barërat	1,214	1,249	1,681	1,555	1,306	1,868	2,006	0
Mbrojtja e dhëmbëve	638	667	687	522	521	630	0	0
Shpenzimet ortopedike	208	154	143	111	134	160	280	135
Shërimi jashtë vendit	290	161	70	90	144	221	117	115

Llojet tjera të shërimit (kompensimet)	719	801	694	769	832	968	941	972
Administrata	326	288	250	268	360	309	264	224
Pajisja dhe mirëmbajtja	36	39	90	44	656	219	23	44
Shpenzimet tjera	41	231	200	48	23	32	27	0
Kreditë dhe kamata	0	0	321	71	154	90	17	0
DALLIMI								
Deficiti/suficiti	-2,602	376	326	90	45	21	164	-162

Tabela 7: Buxheti i Fondit për sigurim shëndetësor sipas viteve


Burimi: Të dhënat e brendshme të Ministrisë për financa

Vërejtje: Shuma për vitin 2005 e mbulon periudhën për dhjetë muajt e parë të vitit, deri në tetor 2005.

Agjencia për punësim

Dotacionet nga buxheti kanë pjesëmarrje më të madhe në strukturën e të hyrave të Agjencisë për punësim, kurse në vetë strukturën e dotacioneve nga Buxheti, pjesa më e madhe është në bazë të mbulimit të deficitit të Agjencisë.

Të dalat ndahen në të dala për funksionimin e Agjencisë dhe të dala për shërbimin profesional. Të dalat për funksionimin e Agjencisë marrin pjesë me mbi 95% të të gjitha të hyrave, dhe në pjesën më të madhe dedikohen për pagesën e kompensimeve në të holla për të papunësuarit, kurse një pjesë e vogël e mjeteve janë për shpenzimet e masave aktive (për nxitjen e punësimit dhe kompensimit për rikualifikim). Në tabelën 8 mund të shihen të hyrat dhe dalat për secilën kategori sipas viteve të dhëna. Njëherazi mund të shihet edhe raporti ndërmjet të hyrave dhe të dalave, gjegjësisht suficitit dhe deficitit të realizuar në Buxhetin e Agjencisë sipas viteve të dhëna.



Grafiku 10: Struktura e të hyrave dhe të dalave për funksionimin e Agjencisë për punësim në vitin 2003

AGJENCIA PËR PUNËSIM

(në mln. denarë)

Lloji i të hyrave/ dalave	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Janar-Tetor
TË HYRAT	4,260	4,129	5,119	4,827	5,918	6,241	7,456	5,816
Të hyrat nga kontributet	990	1,058	1,121	1,136	1,180	1,224	1,270	1,065
Të hyrat nga rrogat	969	1,037	1,098	1,113	1,178	1,223	1,155	961
Të hyrat nga njerëzit me punë që kryejnë veprimtari të mëvetëshme	22	21	22	23	2	0	24	19
Kontributi i paguar nga punëtorët në punë të përkohshme jashtë vendit	0	0	0	0	0	1	4	4
Kontributi nga viti i kaluar	0	0	0	0	0	0	88	91
Dotacionet nga Buxheti i Republikës	3,261	3,066	3,990	3,677	4,726	5,002	6,163	4,743
Për mbulimin e deficitit të Entit shtetëror për punësim	2,737	2,575	3,470	3,170	3,472	3,958	4,522	3,882
Për pagesën e kompenzimit në të holla për të punësuarit e ndërmarrjeve që punojnë me humbje	524	490	616	481	944	980	988	361
Reforma e administratës publike	/	/	/	26	19	3	61	20
Sipas bazave tjera	0	0	3	26	21	61	592	480
Të hyrat tjera	9	6	8	13	12	16	23	8
TË DALAT	4,264	4,135	5,110	4,749	5,868	6,214	7,325	5,818
Të dalat për funksionin	4,084	3,970	4,913	4,571	5,658	6,005	7,102	5,637

Mjetet për sigurimin e kompensimit në të holla për të papunësuarit	2,073	1,755	1,876	1,879	2,273	2,377	2,697	2,042
Kontributet për sigurim shëndetësor	1,039	1,347	1,936	1,555	1,763	1,849	1,998	1,717
Kontributet për sigurim pensional dhe invalidor	972	868	1,102	1,138	1,453	1,657	1,729	1,307
Mjetet për punësimin e personave-invalidë	/	/	/	/	128	121	58	89
Pagesa sipas Ligjit për nxitjen e punësimin	/	/	/	/	/	61	592	458
Kompensimi për rikuilifikim	/	/	/	/	41	40	29	24
Të dalat për shërbimin profesional	180	165	198	178	210	209	223	181
Rrogat dhe mëditjet themelore	99	105	118	116	124	134	132	110
Kompensimet	14	17	19	18	22	20	20	16
Mallrat dhe shërbimet tjera	43	34	64	43	42	51	68	55
Transferet rrjedhore	0	0	0	0	0	0	0	0
Pagesat e kamatave	0	0	1	0	0	0	0	0
Shpenzimet kapitale	24	8	6	2	22	4	3	0
DALLIMI								
Deficiti/ suficiti	-4	-5	9	78	50	27	132	-2

Tabela 8: Buxheti i Agjencisë për punësim sipas viteve

Burimi: Te dhënat e brendshme të Ministrisë për financa

Vërejtje: Shuma për vitin 2005 e mbulon periudhën për dhjetë muajt e parë të vitit, deri në tetor 2005.

Fondi për rrugë magjistrale dhe rajonale

Pjesëmarrje më të madhe në të hyrat e përgjithshme kanë të hyrat nga Buxheti, vijnë kreditë e huaja, dhe në vend të tretë janë mjetet e kompensimit vjetor për automjetet motorike. Pjesa më e madhe e shpenzimeve janë në pjesën e investimeve, pastaj mirëmbajtjen dhe mjetet për rrugë, studime, projekte, mbikëqyrje, provizione, shpenzime materiale, etj. Në tabelën 9 mund të shihen të hyrat dhe dalat për secilën kategori sipas viteve të dhëna. Njëherazi mund të shihet edhe raporti ndërmjet të hyrave dhe të dalave, gjegjësisht suficitit dhe deficitit të realizuar në Buxhetin e Fondit sipas viteve të dhëna.

FONDI PËR RRUGËT MAGJISTRALE DHE RAJONALE

(në mln. denarë)

Lloji i të hyrave/ dalave	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Realizuar	Janar-Tetor
TË HYRAT	2,660	3,739	3,506	4,012	3,434	3,668	3,299	2,624
Të hyrat nga Buxheti	668	924	1,590	1,655	1,305	1,603	1,610	1,200
Kompensimi për shfrytëzimin e rrugëve nga automjetet motorike të huaja	49	54	82	73	87	82	77	73
Kompensimi vjetor për automjetet motorike të cilat i nënshtrohen regjistrimit	524	518	746	704	761	797	853	696
Kompensimi për shfrytëzimin e autostradave	468	492	537	375	381	728	741	625
Kreditë e huaja	939	1,793	538	1,098	862	418	9	0
Të hyrat tjera	12	13	14	21	2	39	9	30
Grantet	/	/	/	87	26	1	0	0
TË DALAT	2,660	3,793	3,506	4,013	3,420	3,661	3,889	2,765
Investimet	1,203	1,985	1,662	1,756	1,260	1,107	1,753	1,113
Të dalat për studimet, projektimet, mbikëqyrjet, provizionet dhe shenzimet materiale	0	0	179	286	289	206	156	135
Mirëmbajtja e rrugëve	784	790	962	926	900	1,063	1,081	960
Pagesa e kredive	284	148	212	299	304	424	242	200
Mjetet për rrugët lokale	321	386	502	596	528	666	611	332
Shpenzimet tjera	89	142	0	0	0	46	45	25
Detyrimet nga viti i kaluar	0	342	0	0	0	0	0	0
Detyrimet ndaj Agjencisë për sanimin e bankave	0	0	0	150	149	150	0	0
DALLIMI								
Deficiti/suficiti	0	0	0	-1	14	7	-590	-141

Tabela 9: Buxheti i Fondit për rrugë magjistrale dhe rajonale sipas viteve

Burimi: Të dhënat e brendshme të Ministrisë për financa

Vërejtje: Shuma për vitin 2005 e mbulon periudhën për dhjetë muajt e parë të vitit, deri në tetor 2005.

1.8 Buxheti i konsoliduar i Republikës

Deri tani e kemi shqyrtuar Buxhetin qendror të Republikës së Maqedonisë dhe buxhetet e fondeve jashtëbuxhetore. Na ka mbetur edhe buxheti i njësisve të vetëqeverisjes lokale. Para se të kalojmë në shqyrtimin e tij, është mirë të shqyrtojmë një kategori tjetër të lidhur me Buxhetin qendror dhe fondet jashtëbuxhetore, gjegjësisht ta shqyrtojmë buxhetin e tyre të konsoliduar.

Buxheti i konsoliduar i pushtetit qendror dhe fondeve jashtëbuxhetore është përmbledhje e të hyrave dhe shpenzimeve të Buxhetit qendror dhe fondeve jashtëbuxhetore, duke mos i marrur parasysh buxhetet e njësisve të vetëqeverisjes lokale, ku anashkalohen transferet e ndërsjella të të hollave mes Buxhetit qendror në fondet jashtëbuxhetore dhe transferet ndërmjet fondeve jashtëbuxhetore. Kjo bëhet më qëllim që të shihet se sa mjete janë mbledhur në dy pjesët e buxhetit, dhe sa mjete janë shpenzuar, gjegjësisht cila është gjendja reale financiare sipas fondeve të ndara jashtëbuxhetore, dhe cila është gjendja e marrëdhënieve financiare ndërmjet Buxhetit qendror dhe fondeve jashtëbuxhetore.

Do të thotë se për konsolidimin e buxhetit, nevojitet:

- anulimi i transfereve të të hollave ndërmjet fondeve jashtëbuxhetore (p.sh. në Fondin për shëndetësi anullohen transferet nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor, dhe nga Agjencia për punësim), dhe
- anulimi i transfereve të të hollave nga Buxheti qendror në fondet jashtëbuxhetore.
-

Pas anulimit të këtyre transfereve fitohet pasqyra reale për të hollat e mbledhura, gjegjësisht të shpenzuara nga Buxheti qendror dhe fondet jashtëbuxhetore.

Në tabelën 10 paraqitet buxheti i konsoliduar i pushtetit qendror dhe fondeve jashtëbuxhetore të Maqedonisë për vitet 2001-2005. Mund të shihet se në të hyrat e përgjithshme përfshihen të gjitha të hyrat e realizuara nga pushteti qendror dhe fondet, kurse në shpenzimet e përgjithshme hyjnë të gjitha shpenzimet e realizuara, ku nuk përfshihen transferet e ndërsjella, si në rastin paraprak të Buxhetit qendror, ose buxhetet e fondeve. Edhe Buxheti i konsoliduar më së shpeshi përfundon me suficit ose deficit, ku dallimi në baraspeshë financohet në mënyrën e shpjeguar paraprakisht në pjesën e Buxhetit qendror.

TË HYRAT DHE DALAT E BUXHETIT QENDROR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Buxhet

	2001	2002	2003	2004	2005
GJITHSEJ TË HYRAT	52,829	58,160	53,881	56,982	56,502
Të hyrat tatimore	47,716	54,389	49,163	52,526	52,321
Tatimi mbi të ardhurat personale	7,248	7,513	7,502	7,707	7,931
Tatimi mbi fitim	3,006	2,624	3,271	2,361	2,571
TVSH	17,132	20,521	21,175	25,757	25,623
Akczizat	10,830	10,715	10,564	10,335	10,965
Tatimet për import	6,111	6,336	6,140	5,815	4,731
Tatimet tjera	275	340	476	548	500
Tatimi mbi transaksionet financiare	3,111	6,336	31	0	0
Taksat komunale	3	4	4	4	0
Të hyrat jotatimore	4,349	3,170	4,040	3,844	3,561
Fitimi i institucioneve publike financiare	1,847	1,057	1,807	1,595	1,661
Tatimet dhe taksat administrative	1,061	1,092	1,369	1,463	1,390
Taksat tjera administrative	486	205	370	257	300
Të hyrat tjera jotatimore	32	35	495	529	210
Të hyrat e koncesioneve (OTE)	923	781	0	0	
Të hyrat kapitale	349	601	555	600	620
Donacionet e huaja	415	0	0	11	0
GJITHSEJ TË DALAT	65,575	65,503	56,432	56,611	59,206
Shpenzimet rrjedhëse	44,017	51,591	50,984	51,726	53,467
Rrogat dhe kompensimet	16,407	18,338	20,234	20,944	21,757
Mallrat dhe shërbimet	6,358	8,715	6,914	6,832	7,352

Transferet	16,950	20,576	21,105	21,840	21,859
Fondi për SPIM	5,215	6,538	7,305	8,054	7,705
Enti për punësim	3,548	4,111	4,360	5,438	5,494
Transferet tjera	2,349	3,404	3,264	3,056	3,496
Shpenzimet për refugjatë	582	391	259	272	100
Reformat strukturore	239	1,387	1,659	732	634
Reforma e administratës publike	944	442	528	527	657
Pagesat për kamatat	4,212	3,401	2,443	2,052	2,499
Kamatat për borxhet e brendshme	1,066	1,179	950	930	1,069
Kamatat për borxhet e jashtme	3,146	2,222	1,493	1,123	1,430
Garancitë	90	561	288	58	0
Shpenzimet kapitale	7,723	8,636	5,037	4,886	5,739
Investimi në mjetet e përhershme	3,589	2,718	1,737	2,187	3,428
Transferet kapitale	2,211	2,476	2,796	2,368	1,919
Rezervat	546	418	0	0	0
Institucionet financiare ndërkombëtare	35	22	18	18	42
Projektet e telekomit	1,342	3,002	486	313	0
Shpenzimet e lidhura me krizën	13,835	5,276	412	0	0
Ministria për mbrojtje			195	0	
Rrogat dhe lejet (për punësim të reja)			0	0	
Të mirat dhe shërbimet			0	0	
Investimet kapitale (pajisja)			217	0	
Depoziti për telekomunikata			0	0	
Ministria për punë të brendshme			217	0	
Rrogat dhe lejet			0	0	

Të mirat dhe shërbimet					0	0	
Investimet kapitale (pajisja)					0	0	
Forcat policore speciale					0	0	
Shpenzimet tjera					0	0	
DEFICITI / SUFICITI BUXHETOR		-12,746	-7,343	-2,551	371	-2,704	
FINANCIMI							
Derdhjet		12,746	7,343	2,551	-371	2,704	
Të hyrat nga privatizimi		10,837	5,177	4,673	459	1,041	
Donacionet e huaja		0	2,641	2,560	1,044	816	
Kapitalizimi		604	0	0	0	0	
Borxhi i jashtëm		763	1,548	3,773	2,081	2,636	
Depozitet		5,399	4,029	-422	1,268	3,044	
Borxhi i brendshëm		1,169	0	0	1,909	2,500	
Shpenzimet		6,526	6,087	8,034	7,132	7,333	
Pagesa e shumës themelore		3,550	6,087	8,034	7,132	7,333	
Borxhi i jashtëm		3,543	3,602	3,682	2,932	2,919	
Borxhi i brendshëm		7	2,485	4,352	4,201	4,414	
Obligacionet		2,976	0	0	0	0	

Tabela 10: Buxheti i konsoliduar për vitet 2001 – 2005

1.9 Buxheti i njësive të vetëqeverisjes lokale

Njësitet e vetëqeverisjes lokale i hartojnë, propozojnë dhe miratojnë buxhetet e tyre në mënyrë të mëvetësishme.

Buxheti është plan vjetor për financimin e ingjercave të komunave, i cili përbëhet nga vlerësimi vjetor i të hyrave sipas burimeve, dhe të dalave sipas dedikimeve.

Shfrytëzuesit buxhetorë komunalë janë organet e komunës dhe shërbimet publike të themeluara nga komuna. Kjo do të thotë se buxheti i përmban mjetet e Këshillit, Kryetarit të komunës, organeve administrative (organeve komunale), si dhe programet për rregullimin komunal, ndriçimin rrugor, rrugët, hapësirat e gjelbra, pyllëzimin dhe programet tjera (të shërbimeve publike të themeluara nga komuna).

Të hyrat e buxhetit të njësive të vetëqeverisjes lokale sigurohen nga:

- burimet vetanake;
- dotacionet nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe të fondeve;
- donacionet e pranuar nga vendi dhe jashtë (si mallra ose të holla), dhe
- në bazë të huazimit nga Buxheti i Republikës, dhe nga vendet e huaja, pas pëlqimit paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Shpenzimet e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes lokale përbëhen nga:

- shpenzimet rrjedhëse (rrogat, mëditjet dhe kompensimet, shpenzimet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, transferet rrjedhëse dhe pagesat për kamatat);
- shpenzimet kapitale (blerja e mjeteve kapitale dhe transferimet kapitale), dhe
- pagesa e shumës themelore të borxheve të marrura.

1.9.1 Të hyrat

Si burime vetanake të të hyrave të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes lokale paraqiten:

1. Tatimet lokale²:

- tatimi mbi pasuri;
- tatimi mbi trashëgimi dhe dhurata, i përcaktuar me ligj;
- tatimi mbi qarkullimin me patundshmëri;

2. Taksat lokale³:

² Tatimi lokal është tatimi për të cilin komuna e përcakton lartësinë e shkallës tatimore.

- taksat komunale;
- taksat administrative;

3. Kompensimet lokale⁴ :

- kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore;
- kompensimet e veprimtarisë komunale;
- kompensimet për planet hapësinore dhe urbanistike;

4. Të hyrat nga pronësia:

- të hyrat nga qiraja;
- të hyrat nga kamata, dhe
- të hyrat nga shitja e pronës;

5. Të hyrat nga donacionet;

6. Të hyrat nga gjobat;

Të hyrat realizohen edhe nga tatimi mbi të ardhurat personale, të arkëtuara gjatë vitit rrjedhës, si në vijim:

- 3% e tatimit mbi të ardhurat personale për personat fizikë, të arkëtuar në komunën ku personi ka paraqitur vend të banimit dhe qëndrimin të përhershëm, dhe
- 100% e tatimit mbi të ardhurat personale për personat fizikë, të cilët merren me veprimtari të zejtarisë, të regjistruar në komunë.

1.9.1.1 Dotacionet nga Buxheti i Republikës dhe buxhetet e fondeve

Dotacioni është transfer nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, dhe buxhetet e fondeve për buxhetet komunale.

Me dotacionet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe buxhetet e fondeve sigurohen të hyrat plotësuese për buxhetin komunal, në rastet kur komuna nuk është në gjendje që vetë t'i financojë aktivitetet e saj nga burimet vetanake.

³ Taksat lokale është kompensim në të holla për shërbimet dhe të drejtat të cilat jepen nga organet komunale për personat fizikë dhe juridikë. Lartësia e tyre caktohet nga komuna

⁴ Kompensimi lokal është kompensim në të holla për mbulimin e shpenzimeve të lidhura me shërbimet të cilat organet komunale ia japin personave fizikë dhe juridikë. Lartësia e tyre caktohet nga komuna.

Nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe buxhetet e fondeve ndahen këto loje të dotacionit:

- të hyrat nga tatimi i vlerës së shtuar;
- dotacionet e dedikuara;
- dotacionet kapitale;
- bllok dotacionet;
- dotacionet për ingjerenat e deleguara.

Të hyrat nga tatimi i vlerës së shtuar sigurohen në vlerë prej 3% të TVSH-së së arkëtuar në përgjithësi, të realizuar gjatë vitit paraprak. Shpërndarja bëhet sipas kriterëve të caktuara paraprakisht në nivel shtetëror.⁵

Klasifikimi i dotacioneve bëhet varësisht nga qëllimi për të cilin aprovohet dotacioni për komunën. Për shembull, dotacioni i dedikuar është dotacion i cili dedikohet për financimin e ndonjë aktiviteti konkret të komunës. Dotacioni kapital është dotacion i cili dedikohet për financimin e projekteve komunale për investime kapitale. Bllok dotacioni është dotacion i cili dedikohet për financimin e ingjerenave të ndonjë fushe të caktuar.⁶ Dhe në fund, dotacioni për ingjerenat e deleguara është transferi i mjeteve nga organi i administratës shtetërore deri te komuna, të cilat shfrytëzohen për financimin e ingjerenave të deleguara nga organi i administratës shtetërore tek Kryetari i komunës.

1.9.2 Si përgatitet buxheti i njësive të vetëqeverisjes lokale?

Ligji për buxhete e rregullon mënyrën e përgatitjes, miratimit dhe shpenzimit të buxheteve të njësive të vetëqeverisjes lokale. Dinamika e miratimit të buxheteve lokale dakordohet me dinamikën e miratimit të Buxhetit qendror. Procesi fillon me përgatitjen e rekomandimeve nga ministri i financave për shumën e të hyrave dhe të dalave buxhetore për vitin vijues, të cilat ia dorëzon Qeverisë. Pas kësaj, Ministri lëshon letër qarkore ku përmbahen udhëzimet për njësitë e vetëqeverisjes lokale lidhur me buxhetet komunale. Ligji parasheh afat deri më 30 shtator (neni 27). Njësitë e

⁵ Është miratuar Urdhëresa për Metodologjinë e shpërndarjes të të hyrave nga tatimi i vlerës së shtuar sipas komunave (korrik 2005). Mjetet shpërndahen në këtë mënyrë: nga të ardhurat e përgjithshme të TVSH-së, 2% mbeten si fond rezervë për komunat të cilat nuk mund t'i mbulojnë shpenzimet për aktivitetet të cilat duhet t'i realizojnë. Nga pjesa tjetër, Qyteti i Shkupit merr 10%, prej të cilave 40% i jepen pushtetit të Qytetit, dhe mbetja ndahet mes komunave të Shkupit, në bazë të formulës 60% sipas popullatës, 27% sipas sipërfaqes, dhe 13% sipas numrit të vendbanimeve. Restoja prej 90% ndahet mes të gjitha komunave tjera (përfshirë Shkupit) sipas formulës 60% në bazë të popullatës, 27% sipas sipërfaqes, dhe 13% sipas numrit të vendbanimeve.

⁶ Bllok-dotacioni shfrytëzohet për financimin e ingjerenave të caktuara të përcaktuara sipas programeve konkrete.

vetëqeverisjes lokale përgatisin propozim-buxhet dhe ia dorëzojnë Ministrin për financa, i cili e aprovon atë.

Afatet për planifikimin e buxhetit lokal rregullohen me kalendarin buxhetor, të miratuar nga Këshilli komunal. Këshilli komunal e miraton buxhetin për vitin vijues deri më 31 dhjetor. Në qoftë se deri në këtë afat nuk miratohet buxheti, Këshilli duhet të miratojë vendim për financim të përkohshëm, dhe plan financiar për realizimin e saj për periudhën prej 1 janarit deri më 31 mars të vitit rrjedhës. Në këtë rast, Kryetari i komunës duhet ta aprovojë pagesën e mjeteve nga buxheti sipas shpenzimeve të vitit paraprak fiskal, për secilin muaj sipas paragrafeve në periudhën e financimit të përkohshëm, por jo më tepër se një e njëzeta e shpenzimeve të realizuara gjatë vitit paraprak.

1.9.3 Si duket buxheti i njësive të vetëqeverisjes lokale?

Buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale, gjegjësisht buxhetet komunale dallohen tepër pak mes vete, me përjashtim të shumave. Për të krijuar një parafytyrim për dukjen e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes lokale, mjafton të shihet buxheti i cilësdo komunë. Ne si shembull e kemi marrur buxhetin e Komunës së Strumicës, të planifikuar dhe realizuar për vitin 2005.

Nga buxheti në vijim mund të shohim se pjesa më e madhe e të hyrave arkëtohen nga transferet dhe burimet tatimore, kurse kur flasim për shpenzimet (të dalat), pjesa më e madhe i takon shpenzimeve kapitale, pastaj shpenzimeve rrjedhëse (për mirëmbajtje rrjedhëse, rrogat dhe kompensimet e njësisë së vetëqeverisjes lokale).

Në buxhetin në vijim, tatimi për shërbimet specifike i nënkupton taksat komunale. Do të thotë se taksat komunale trajtohen si të hyra tatimore, dhe ato marrin pjesë me 31% në të hyrat e përgjithshme. Transferet marrin pjesë me 40% në të hyrat e përgjithshme, por kjo nuk do të thotë se ato kanë pjesëmarrje më të madhe në të hyrat e përgjithshme të të gjitha komunave. Më lartë kemi cekur se ekzistojnë kriteret të caktuara gjatë shpërndarjes së transfereve të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, në buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale të shfaqura në vijim.

Kur flitet për shpenzimet, shpenzimet kapitale marrin pjesë me rreth 34.56% në shpenzimet e përgjithshme, shpenzimet rrjedhëse (rrogat dhe kompensimet, mallrat dhe shërbimet) marrin pjesë me 19%, dhe transferet me 2% në të dalat e përgjithshme. Për dallim nga të hyrat e përgjithshme, kur me transferet janë nënkuptuar dotacionet nga Buxheti i Republikës për njësitë e vetëqeverisjes lokale, të të dalat e përgjithshme i nënkuptojmë transferet nga buxheti i njësisë së vetëqeverisjes lokale për amvisëritë dhe personat fizikë, organizatat joqeveritare dhe nivelet tjera të qeverisjes në komunën e caktuar.

	Përshkrimi	Bbuxheti	Vetëfinancimi	Donacionet	Të dedikuara	Kredi	Gjithsej
	STRUMICA	169,270,420	29,831,662	3,900,000	36,498,200	-	239,500,282
71	TË HYRAT TATIMORE Tatimi nga të ardhurat, fitimi dhe fitimet kapitale	102,847,572	-	-	-	-	102,847,572
	Tatimi mbi pasuri	5,454,000	-	-	-	-	5,454,000
	Tatimet mbi shërbimet specifike	22,554,000	-	-	-	-	22,554,000
	Taksat për shfrytëzim ose lejet për kryerjen e veprimtarive	73,839,572	-	-	-	-	73,839,572
72	TË HYRAT JOTATIMORE Taksat dhe kompensimet	1,000,000	-	-	-	-	1,000,000
	Taksat dhe kompensimet administrative	10,408,000	28,270,140	1,900,000	-	-	40,578,140
	Shërbimet tjera qeveritare	3,300,000	-	-	-	-	3,300,000
	Të hyrat tjera jotatimore	1,500,000	26,218,000	-	-	-	27,718,000
	Shërbimet tjera qeveritare	2,000,000	-	-	-	-	2,000,000
73	TË HYRAT KAPITALE Shitja e mjeteve kapitale	3,608,000	2,052,140	1,900,000	-	-	7,560,140
	TRANSFERET DHE DOTACIONET	200,000	-	-	-	-	200,000
74	Transferet nga nivelet tjera të pushtetit	200,000	-	-	-	-	200,000
	Donacionet nga jashtë	55,814,848	1,561,522	2,000,000	36,498,200	-	95,874,570
	Donacionet kapitale	55,814,848	1,561,522	-	36,498,200	-	93,874,570
	Donacionet nga jashtë	-	-	1,600,000	-	-	1,600,000
	Donacionet kapitale	-	-	400,000	-	-	400,000

Tabela 11: Të hyrat e njësisë të vetëqeverisjes lokale Strumicë për vitin 2005

Përshkrimi	Buxheti	Vetëfinansimi	Donacionet	Të dedikuara	Kredi	Gjithsej
STRUMICA	169,270,420	29,831,662	3,900,000	36,498,200		239,500,282
RROGAT, MËDITJET,KOMPENSIMET	38,299,874	450,280		7,432,900		46,183,054
Rrogat themelore dhe kompensimet	28,447,976	320,840		5,106,296		33,875,112
Kompensimet për sigurimin social nga punëdhënësit	9,851,898	129,440		2,326,604		12,307,942
MALLRAT DHE SHËRBIMET	49,185,878	27,051,182	950,000	29,065,300		106,252,360
Të dalat për mëditje, udhëtime	941,600	866,000		40,596		1,848,196
Shërbimet komunale, ngrohja, komunikimi dhe transporti	16,231,650	3,920,600	250,000	14,802,676		35,204,926
Inventari i vogël, materialet e tjera për riparim	4,729,012	10,379,784	520,000	1,791,355		17,420,151
Meremetimet dhe mirëmbajtja	15,845,000	3,996,938		1,864,736		21,706,674
Shërbimet kontraktuese	8,637,616	7,132,860		10,565,937		26,336,413
Të dalat tjera rrjedhëse	2,801,000	755,000	180,000			3,736,000
TRANSFERET RRJEDHËSE TË NJËSISË SË VETËQEVER. LOKALE	70,000					70,000
Dotacionet e dedikuara	70,000					70,000
SUBVENCIONET DHE TRANSFER.	3,576,000		450,000			4,026,000
Subvencionet për ndërmarrjet publike	350,000					350,000
Subvencionet për Organ. joqeveritare	1,110,000					1,110,000
Transferet e ndryshme	2,116,000		450,000			2,566,000

Beneficionet sociale	180,000					180,000
Kompensimet sociale	180,000					180,000
TË DALAT KAPITALE	77,958,668	2,330,200	2,500,000			82,788,868
Objektet ndërtimore	500,000	200,000				700,000
Objektet tjera ndërtimore	65,188,668	1,030,000	2,500,000			68,718,668
Blerja e mobiljeve, pajisjes, veturave, makina	4,300,000	1,100,200				5,400,200
Mjetet tjera jofinanciare	7,970,000					7,970,000

Tabela 12: Të dalat e njësisë të vetëqeverisjes lokale Strumicë për vitin 2005

1.9.4 Decentralizimi në faza

Decentralizimi në nivel lokal realizohet në disa faza, me qëllim të tejkalimit të rreziqeve të mundshme në aspekt të stabilitetit fiskal dhe makroekonomik të ekonomisë nacionale, delegimit të ingjercave dhe mjeteve shoqëruese fiskale nga niveli qendror në nivelin lokal. Qasja e fazave parashihet me Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Në fazën e parë parashihet ndërmarrja e pronës dhe obligimit të pagesës së shpenzimeve për mirëmbajtjen e ingjercave të decentralizuara, në pajtim me nenin 22 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (planifikimi urbanistik, mbrojtja e ambientit jetësor, planifikimi i zhvillimit ekonomik lokal, veprimtaritë komunale, sporti dhe rekreimi, veprimtaritë për mbrojtje nga zjarri, përkrahja institucionale dhe financiare e enteve të kulturës, mbrojtjes sociale, gjegjësisht menaxhimi, financimi, investimi dhe mirëmbajtja e kopshteve për fëmijë dhe enteve për të moshuarit, themelimi, financimi dhe menaxhimi me shkollat fillore dhe të mesme, menaxhimi me rrjetin e organizatave të shëndetit publik dhe objektet e mbrojtjes primare shëndetësore). Kushti për fillimin e kësaj faze ka qenë që 90 për qind e komunave të cilat mbulojnë 90 për qind të territorit të shtetit të kenë të punësuar 2 ekspertë financiarë dhe 3 ekspertë për përgatitjen dhe mbledhjen e tatimeve. Deri më 1 korrik 2005, komunat kanë qenë të detyruara të fillojnë më realizimin e planit për zgjidhjen e borxheve të mbetura ndaj realizuesve dhe kreditorëve tjerë, për të gjitha detyrimet e realizuara deri më 31 dhjetor 2004. Ministria për financa duhet të sigurojë kornizë për aktivitetet me të cilat do të zgjidhen borxhet e mbetura.

Në kuadër të fazës së dytë, komunat duhet të ndërmarrin ingjercenca më të mëdha përmes bllok-dotacioneve: menaxhimin e tërësishëm me buxhetet e shkollave (fillore dhe të mesme), përfshirë këtu edhe pagesën e rrogave për profesorët, menaxhimin dhe financimin e enteve sociale gjegjësisht institucioneve të mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve (kopshtet e fëmijëve dhe entet për të moshuarit), përkrahja institucionale dhe financiare e enteve kulturore dhe menaxhimi me entet e shëndetësisë publike të shëndetësisë primare, përmes përfshirjes në këshillat drejtues të këtyre enteve. Për ta siguruar transferin e bllok-dotacioneve në fazën e dytë, komunat duhet t'i plotësojnë këto kriteret:

- duhet t'i plotësojnë kushtet e lartëcekura të fazës së parë;
- duhet të kenë kapacitet adekuat njerëzor për menaxhim financiar;
- duhet të tregojnë rezultate të mira financiare në punën e minimum 24 muajve;
- duhet të parashtrijnë raporte financiare për të paktën 24 muaj, të cilat i dorëzohen Ministrisë për financa, e cila duhet t'i aprovojë;
- duhet të mos kenë detyrime të pashlyera ndaj furnizuesve ose kreditorëve tjerë, të cilat i tejkalojnë kushtet e zakonshme të pagesës në treg.

Gjatë kësaj, parashihet që bllok-dotacionet të mos transferohen automatikisht pas plotësimit të kushteve të lartëcekura, por pas parashtrimit të kërkesave nga ana e komunave. Sipas disa llogaritjeve, përmes bllok-dotacioneve të fazës së dytë do të

transferohen rreth 9 miliardë denarë për arsim, 30 milionë denarë për shëndetësinë primare, 1 miliardë për mbrojtjen sociale, dhe 200 milionë për kulturën.

* * *

Si përmbledhje - i kemi shqyrtuar të gjitha buxhetet të cilat hasen në Republikën e Maqedonisë. Konkretisht, e kemi shqyrtuar Buxhetin e Republikës, i cili përbëhet nga Buxheti qendror dhe fondet jashtëbuxhetore, dhe buxheti i njësisve të vetëqeverisjes lokale. Kemi dhënë shembuj konkretë për secilin buxhet, i kemi shpjeguar të hyrat dhe të dalat e përgjithshme, dhe llojet e tyre, e kemi shfaqur pjesëmarrjen e secilit prej tyre në të hyrat dhe dalat e përgjithshme, gjegjësisht klasifikimin e tyre. Në pjesën e posaçme e kemi elaboruar dallimin mes të hyrave të përgjithshme dhe të dalave të përgjithshme të buxhetit, që njihet edhe si suficit dhe deficit buxhetor, dhe nevojën e financimit të tij, për shkak se secili buxhet duhet të jetë i baraspeshuar sipas parimit të baraspeshës buxhetore.

Në Grafikon 8 paraqitet deficiti buxhetor prej vitit 2001-2005, gjegjësisht suficiti buxhetor në vitin 2004 dhe 2005. Deficiti buxhetor financohet me huazimin e borxheve nga vendi dhe shtetet e huaja, dhe detyrimet e përgjithshme të sektorit publik për këtë bazë njihen edhe si borxh publik.

1.10 Borxhi publik

Duke u nisur nga fakti se borxhi publik përbëhet nga detyrimet e përgjithshme të shtetit në bazë të borxheve të brendshme dhe të jashtme, atëherë sipas burimit të huazimit, borxhi publik ndahet në borxh publik të brendshëm dhe të jashtëm. Detyrimet e përgjithshme të shtetit i përfshijnë detyrimet për nevojat e buxhetit qendror dhe fondeve jashtëbuxhetore, si dhe detyrimet për huazimet e organeve shtetërore, për nevojat e buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes lokale. Në tabelën 13 shfaqen shumat e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm të Republikës së Maqedonisë, sipas viteve (1999-2005), si dhe pjesëmarrja e borxhit publik në bruto-prodhimin vendor (BPV).

Në miliona EUR							
Baza	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Borxhi i jashtëm publik	1,290	1,428	1,398	1,268	1,179	1,178	1.441,16
Borxhi i brendshëm publik	114	791	733	676	665	663	750.19
Borxhi i plotë publik	1,403	2,219	2,130	1,944	1,844	1,841	2.191,36
BPV	3,448	3,877	3,838	3,991	4,095	4,207	4,641.39
Borxhi i brendshëm publik/BPV	40.7	57.2	56.5	48.7	45.0	43.8	48.54


Tabela 13: Gjendja e borxhit publik në Republikën e Maqedonisë sipas viteve (1999-2005)

Burimi: Ministria për financa

Vërejtje: Shumat jepen në miliona euro


Sipas kësaj mund ta shohim qartë dominimin absolut të borxhit të jashtëm në huazimin e përgjithshëm, gjegjësisht dominimin e tij mbi borxhin e brendshëm. Borxhi i jashtëm është pothuajse dy herë më i madh se i brendshmi. Në vijim jepet raporti relativ mes borxhit të jashtëm dhe të brendshëm në Maqedoni sipas viteve (1999-2005).

Struktura dhe lëvizija e borxhit publik në periudhën 1999-2005 Në miliona EUR



Grafiku 11. Struktura e borxhit publik në Maqedoni sipas viteve (1999-2005)
Burimi: Ministria e financave, BPRM

Gjendja e borxhit të plotë publik (% e BPV)



Grafiku 12. Raporti i borxhit publik me bruto-prodhimin vjetor sipas viteve (1999-2005)
Burimi: Ministria e financave, BPRM

Borxhi publik ka pjesëmarrje relativisht të madhe në bruto-prodhimin vendor. Në vitin 2005 ai ka marrur pjesë me 48,64 (shiqo Grafikon 12). Për shkak të pagesës së kamatave dhe shumës themelore të borxhit, zvogëlohet shuma e të hollave në qarkullim në ekonominë shtetërore, të cilat mund të shfrytëzohen nga shteti për qëllime më produktive. Së këndejmi, borxhi nuk i ngarkon vetëm gjeneratat e sotshme, por edhe të ardhshmet.

Kreditorët më të mëdhenj ndërkombëtarë të Maqedonisë janë: FMN, IBRD, IFC, EIB, BERZH, EUROFIMA, BE, IFAD, Klubi i Parisit dhe i Londrës. Sa i përket strukturës së borxhit të brendshëm, pjesa më e madhe përbëhet prej obligacioneve strukturore të thesarit (rreth 88%), prej të cilave 63,62 janë në pronësi të personave fizikë dhe 36,38% në pronësi të subjekteve juridikë. Obligacionet strukturore të thesarit janë obligacionet të cilat shteti i lëshon dhe shet për ndonjë qëllim të caktuar, sanim, nacionalizim, mbulim të kursimit të vjetër devizor, etj. Pjesa e tjetër e borxhit publik të brendshëm përbëhet nga letrat me vlerë, të lëshuara nga shteti, të cilat janë objekt i shitblerjes në tregun e letrave me vlerë.

KAPITULLI III: PROCEDURA PER MIRATIMIN E BUXHETIT

Procesi buxhetor - përgatitja, miratimi, realizimi

Procesi buxhetor është tërësi e rregullave (formale dhe joformale) të cilat i mundësojnë pushtetit ekzekutiv miratimin e vendimeve të cilat rezultojnë me përgatitjen, miratimin e Buxhetit nga Kuvendi, dhe në fund realizimin e tij. Në procesin buxhetor, Qeveria e përcakton planin buxhetor (si dhe të hyrat dhe dalat e planifikuara), dhe në bazë të këtij plani merren vendimet për shpërndarjen e mjeteve buxhetore. Kjo shpërndarje është mjet i dobishëm për sigurimin e menaxhmentit efektiv të shtetit, dhe i jep rëndësi procesit buxhetor.

Pse është i rëndësishëm procesi buxhetor? Vendimet për mënyrën e mbledhjes dhe shpenzimit të të hollave tona merren në kohën kur planifikohet dhe miratohet buxheti. Kjo është arsye e mjaftueshme për ne, qytetarët e Maqedonisë ta njohim mirë procesin buxhetor, aktorët kryesorë dhe rolet e tyre në planifikimin, miratimin dhe realizimin e Buxhetit.

1. Aktorët e procesit buxhetor

Kush janë aktorët kryesorë të procesit buxhetor? Cilat janë rolet e tyre në procesin buxhetor?

Aktorët kryesorë të procesit buxhetor janë: Kuvendi (pushteti ligjvënës), Qeveria (pushteti ekzekutiv), Ministria për financa, shfrytëzuesit tjerë të Buxhetit dhe njësitë e shfrytëzuesve të Buxhetit, dhe qytetarët e Maqedonisë. Në pika të shkurtëra do t'i përshkruajmë rolet e tyre.

Kuvendi (www.sobranie.mk)

Kuvendi i Maqedonisë është organi përfaqësues i qytetarëve, dhe bartës i pushtetit ligjvënës të shtetit. Kuvendi përbëhet prej një ode, me 120 deri 140 deputetë të cilët zgjedhen në zgjedhje të përgjithshme, drejtëpërdrejte dhe të lira, me votim të fshehtë. Deputetët kanë mandat në kohëzgjatje prej katër viteve. Kuvendi është në seancë të përhershme.

Kuvendi e miraton buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit të shtetit.

Propozim-buxheti shqyrtohet nga shumica e nëntëmbëdhjetë komisioneve të Kuvendit, gjegjësisht nga: komisioni për financim dhe buxhet, komisioni ligjvënës-juridik, komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie ndërmjet bashkësive, komisioni për mbrojtje dhe siguri, komisioni për politikë të jashtme, komisioni për çështje ekonomike, komisioni për bujqësi, pylltari dhe ekonomizimin e ujrave, komisioni për transport, lidhje dhe ekologji, komisioni për arsim, shkencë dhe sport, komisioni për kulturë, komisioni

për shëndetësi, komisioni për punë dhe politikë sociale dhe komisioni për çështje evropiane.

Deputetët kanë mundësi që në diskutimet publike dhe punën e komisioneve parlamentare të japin propozime, propozime për ndryshimin e Propozim-buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe ligjit për realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin gjegjë. Duke u nisur se Kuvendi është organi ligjvënës në Maqedoni, ai e ka fjalën e fundit të miratimit të hyrave dhe të dalave, dhe masave për mbledhjen e të hyrave buxhetore, para se ato të bëhen formalisht pjesë e Buxhetit të Maqedonisë për vitin vijues.

Qeveria (www.vlada.mk)

Qeveria është pushteti ekzekutiv në Maqedoni, dhe i krijon dhe realizon politikat sektoriale të vendit. Përbëhet prej 14 ministrive me të cilat udhëheqin ministrat, dhe udhëhiqet nga Kryetari i Qeverisë dhe zëvendësit e Kryetarit të Qeverisë (për fushat qeveritare me prioritet).

Qeveria ka rol në definimin e prioritetëve të shtetit, politikat e mbledhjes të të hyrave, dhe propozimin e shpërndarjes dhe alokimit të mjeteve buxhetore për realizimin e prioritetëve të shtetit. Roli i Qeverisë në procesin buxhetor është propozimi i politikës fiskale dhe definimi i politikës nacionale buxhetore. Qeveria e përcakton propozim-buxhetin, dhe ia dorëzon Kuvendit të Maqedonisë për miratim.

Ligji për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 59/2000, nr.12/2003) e rregullon organizimin, mënyrën e punës dhe ingjerenat e Qeverisë.

Ministria për financa (www.finance.gov.mk)

Ministria për financa është aktori më i rëndësishëm në procesin buxhetor. Kjo Ministri përbëhet prej 11 sektoreve (Sektori për punët e lidhura drejtëpërdrejtë me Ministrin, Sektori për buxhete, Sektori për punë juridike dhe administrative, Sektori për revizion të brendshëm qendror, Sektori për sistemin financiar, Sektori për financa ndërkombëtare, Sektori për thesar, Sektori për sistemin tatimor dhe doganor, Sektori për informatikë, Sektori për menaxhim me kapital, Sektori për politikë makroekonomike), dhe 7 organe ekzekutive (Drejtoria për çështjet pronëso-ro-juridike, Drejtoria doganore, Inspektorati shtetëror devizor, Drejtoria e të hyrave publike, Byroja për rezervat e mallrave, Drejtoria për parandalimin e pastrimit të parave, Policia financiare).

Ministria e financave i kryen punët e lidhura me:

- sistemin e financimit;
- sistemin e thesarit;
- sistemin doganor;

- sistemin tatimor dhe politikën tatimore;
- sistemin e punëve devizore;
- sistemin e bankave, kursimoreve dhe institucioneve tjera financiare;
- sistemin e kontabilitetit, revizionit dhe qarkullimit pagesor;
- borxhet dhe kreditë;
- politikën makroekonomike dhe politikën e zhvillimit të ekonomisë nacionale;
- përgatitjen e proeksionit të bilancit pagesor;
- përgatitjen dhe përcjelljen e bilanceve makroekonomike;
- sigurimin e pasurisë dhe personave;
- lojërat e fatit;
- përgatitjen dhe realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe llogarisë përfundimtare të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë;
- pronësinë dhe marrëdhëniet tjera pronëso- juridike;
- rezervat e mallrave;
- mbikëqyrjen sipas ingjerecave, dhe
- kryerjen e punëve tjera të caktuara me ligj.

Ministria e financave është një prej shfrytëzuesve të Buxhetit të Maqedonisë, dhe njëherazi hartues dhe realizues i Buxhetit. Planifikimi i Buxhetit dhe përcjellja e realizimit të tij kryhet përmes Sektorit të buxheteve, pranë Ministrisë për financa dhe Sektorit për thesar.

Qytetarët

Ne jetojmë në demokraci në të cilën ne, qytetarët i zgjedhim përfaqësuesit në Kuvend dhe ata e zgjedhin Qeverinë. Njëherazi ne i zgjedhim edhe përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale. Përfaqësuesit tonë në nivel qendror dhe lokal i miratojnë të gjitha vendimet e rëndësishme për shtetin, përfshirë këtu edhe Buxhetin.

Në Buxhet parashihen shuma të mëdha të të hollave, dhe ato shpenzohen përmes Buxhetit të njëjtë. Kjo është arsyeja se pse planifikimi dhe shpenzimi i mjeteve buxhetore nuk është vetëm brengë e përfaqësuesve të Qeverisë, Kuvendit, Ministrisë për financa ose vetëqeverisjes lokale.

Buxheti është tejet i rëndësishëm, dhe për këtë arsye nuk guxon të jetë brengë e vetëm disa individëve, politikanëve ose grupeve të interesit të cilat i përfaqësojnë. Së këndejmi, qytetarët dhe organizatat joqeveritare, mbarë shoqëria civile duhet të jetë e përfshirë në mënyrë aktive në procesin buxhetor. Për këtë do të flasim më tepër në kapitullin e tretë të këtij Udhëzuesi.

Shfrytëzuesit buxhetorë

Me shfrytëzues buxhetor nënkuptohen shfrytëzuesit e mjeteve të Buxhetit nga fusha e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Këtu bëjnë pjesë Kuvendi i Maqedonisë, Qeveria e Maqedonisë, Kryetari i Maqedonisë dhe organet tjera ekzekutive, gjyqësori dhe Gjykata Kushtetuese.

Me njësi shfrytëzuese të Buxhetit nënkuptohen institucionet nga fusha e arsimit, shkencës, kulturës, mbrojtjes së fëmijëve, mbrojtjes sociale, gjyqësorit dhe prokurorisë, të cilat financohen përmes shfrytëzuesit të Buxhetit nga fusha adekuate. Këto janë shkollat, fakultetet, ASHAM, konviktet, kopshtet e fëmijëve, prokuroria publike, avokati publik (prokuratori) dhe avokati popullor.

Shfrytëzuesit dhe njësitë shfrytëzuese të mjeteve të Buxhetit dhe buxheteve të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, Fondit për sigurim shëndetësor, Fondit për rrugë magjistrale dhe Agjencisë për punësim, ndërmarrjeve publike të themeluara nga Kuvendi dhe Qeveria, dhe shoqatat tregtare të themeluara nga shteti, mund të punësojnë nëpunës të ri dhe të krijojnë shpenzime vetëm në qoftë se kanë siguruar mjete nga buxheti për këto qëllime, gjegjësisht nga planet fiskale për vitin fiskal rrjedhës.

2. Fazat themelore të procesit buxhetor

Buxheti është prodhim i procesit buxhetor. Nga ana tjetër, procesi buxhetor është tërësi e marrëdhënieve mes aktorëve kryesore - Qeverisë, Ministrisë për financa, shfrytëzuesve buxhetorë dhe njësite të shfrytëzuesve buxhetorë, në bazë të të cilave Kuvendi diskuton dhe e miraton Buxhetin. Kjo është arsyeja se pse është e rëndësishme të njihet dhe kuptohet mirë procedura për përgatitjen, miratimin, realizimin dhe kontrollin e Buxhetit, me qëllim që ne të ndikojmë në alokimin e resurseve buxhetore.

Cilat janë fazat e procesit buxhetor? Për sa kohë përgatitet, miratohet dhe realizohet Buxheti?

Ligji për Buxhet e rregullon procesin buxhetor dhe përfshin tre faza: përgatitjen, miratimin dhe realizimin.

Faza e parë - **përgatitja e buxhetit** - e përfshin planifikimin e të hyrave dhe të dalave të Buxhetit. Kjo fazë zgjatë shtatë muaj.

Faza e dytë është **diskutimi para Kuvendit të Maqedonisë për Propozim-buxhetin dhe miratimi i Buxhetit**. Kjo fazë zgjatë një muaj.

Faza e tretë është realizimi i buxhetit. Në këtë fazë shpenzohen të hollat e planifikuara të cilat janë mbledhur në Buxhet (përmes të hyrave buxhetore), dhe shpenzohen për qëllimet e planifikuara, të përcaktuara për vitin gjegjës buxhetor. Në këtë fazë bën pjesë edhe kontrollimi i nivelit të të hyrave dhe mbledhura, dhe shpenzimi i mjeteve buxhetore. Kjo fazë zgjatë 15 muaj.

Tërë procesi buxhetor zgjatë 21 muaj.

Cilat janë dallimet ndërmjet Planit buxhetor dhe realizimit të Buxhetit?

Plani buxhetor i përmban të hyrat dhe dalat të cilat Qeveria planifikon t'i mbledhë dhe shpenzon gjatë vitit të ardhshëm. Realizimi i Buxhetit është implementimi real i këtij plani. Në fakt, plani buxhetor dallohet nga Buxheti i realizuar për shkak se të hyrat dhe dalat qeveritare nuk mund të parashihen me përpikëri, për arsye të ndryshme politike, ekonomike dhe sociale. Për ta shpjeguar dallimin mes Buxhetit të planifikuar dhe Buxhetit të realizuar, Qeveria i parashton Kuvendit **llogari përfundimtare** në fund të secilit vit buxhetor, ku jepen shpjegimet për dallimet kryesore mes Buxhetit të planifikuar dhe realizuar.

Për të parë se si realizohet procesi buxhetor, në tabelën në vijim do ta shohim secilën fazë, dhe kohën e nevojshme prej fillimit deri në fund të "vlefshmërisë" së Buxhetit.

Koha, faza dhe hapat	Aktiviteti
Faza e parë	Planifikimi/ përgatitja e Buxhetit
Hapi i parë	Prioritetet strategjike të qeverisë
15 prilli	Qeveria i përcakton prioritetet e saj strategjike
Hapi i dytë	Përgatitja e politikës fiskale për vitin e ardhshëm
Muaji korrik	Ministria për financa e harton raportin për gjendjen fiskale dhe ia dorëzon Qeverisë
Hapi i tretë	Përgatitja e qarkores buxhetore
Muaji prill	Ministri për financa e përgatitë qarkoren buxhetore dhe e dorëzon tek shfrytëzuesit e buxhetit
Muaji qershor	Shfrytëzuesit buxhetorë e përgatisin propozimin e llogaritjes buxhetore
Hapi i katërt	Dorëzimi i kërkesave buxhetore
15 qershor	Kërkesat buxhetore të shfrytëzuesve i dorëzohen Ministrisë për financa
Hapi i pestë	Adaptimi i kërkesave të shfrytëzuesve të buxhetit
Muaji tetor	Ministria për financa i adapton nevojat e shfrytëzuesve ndaj mjeteve të disponueshme të buxhetit për vitin vijues. Në bazë të këtij adaptimi hartohet propozim-buxheti dhe arsyetimet për Buxhetin.
Faza e dytë	Miratimi i Buxhetit
Hapi i parë	Dorëzimi i Propozim-buxhetit në Qeveri
1 nëntor	Ministria për financa ia dorëzon buxhetin Qeverisë
Hapi i dytë	Dorëzimi i Propozim-buxhetit nga Qeveria në Kuvend
15 nëntor	Qeveria e parashtron Propozim-buxhetin në Kuvend
Hapi i tretë	Shqyrtimi i Propozim-buxhetit nga ana e Kuvendit
Muaji dhjetor	Kuvendi diskuton për Propozim-buxhetin
Më së voni deri në fund të dhjetorit	Kuvendi e miraton Buxhetin
Faza e tretë	Realizimi i Buxhetit

Hapi i parë	Dorëzohet plani financiar njëvjeçar
Në afat prej 25 ditëve nga miratimi i Buxhetit	Shfrytëzuesit e Buxhetit ia dorëzojnë Ministrisë për financa planin vjetor sipas kuartaleve
Në afat prej 5 ditëve nga miratimi i Buxhetit	Secila njësi e shfrytëzuesit dorëzon ekstrakt të planit financiar vjetor
Hapi i dytë	Dorëzohet plani financiar kuartal
Më së voni 5 ditë para fillimit të kuartalit	Shfrytëzuesit e Buxhetit hatojnë propozim-plan financiar për kuartalin e caktuar dhe e dorëzojnë në Ministrinë e financave - Sektorin e thesarit
Hapi i tretë	Aprovimi i planeve financiare kuartale dhe realizimi i Buxhetit

Tabela 14

Në vijim do të shpjegohet secila fazë e procesit buxhetor, dhe hapat e veçantë të cilat ndërmerren gjatë përgatitjes, miratimit dhe realizimit të Buxhetit.

Faza e parë: Përgatitja e Buxhetit

Baza për përgatitjen e buxheteve janë prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, strategjia fiskale, propozim-planet strategjike të shfrytëzuesve buxhetorë dhe politikës buxhetore, si dhe prioritetet e komunave.

Ministri për financa është përgjegjës për përgatitjen e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe parashtrimin e tij para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Kryetari i komunës është përgjegjës për përgatitjen e buxhetit komunal, dhe parashtrimin e tij para Këshillit komunal.

Hapi I: Prioritetet strategjike të Qeverisë

Qeveria e Republikës së Maqedonisë i përcakton prioritetet strategjike për vitin vijues, më së voni deri më 15 prill të vitit rrjedhës.

Prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë si tërësi e qëllimeve dhe nismave, patjetër përfshihen nga shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror dhe fondet, përmes programeve dhe nënprogrameve qeveritare

Shfrytëzuesit buxhetorë obligohen të hartojnë plane strategjike trevjeçare në të cilat përmbahen programet dhe aktivitetet për realizimin e prioritetëve strategjike të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë, si dhe qëllimet dhe prioritetet e shfrytëzuesit buxhetor për periudhën e dhënë.

Hapi II: Strategjia fiskale

Ministria për financa e harton Strategjinë fiskale për periudhë afatmesme prej tre viteve, me të cilën i propozon udhëzimet dhe qëllimet e politikës fiskale, dhe i përcakton shumat për kategoritë kryesore të të hyrave të vlerësuara, dhe mjeteve të aprovuara për atë periudhë. Ministria për financa propozon edhe shuma maksimale për mjetet e aprovuara për vitin vijues dhe dy vite tjera fiskale, për secilën fushë funksionale të pushtetit qendror dhe fondeve. Qeveria e Republikës së Maqedonisë i përcakton shumat maksimale për periudhën trevjeçare, më së voni deri në fundin e majit të vitit rrjedhës fiskal.

Strategjia fiskale i përmban:

- 1) parakushtet themelore ekonomike dhe rekomandimet për përgatitjen e Propozim-buxhetit të Republikës së Maqedonisë;

- 2) vlerësimin për shumën e të hyrave, dalave dhe financimin e Buxhetit për vitin rrjedhës fiskal;
- 3) vlerësimin për lartësinë e të hyrave, dalave dhe financimin e Buxhetit në afat të mesëm prej tre viteve, dhe
- 4) të dhënat tjera të nevojshme.

Hapi III: Qarkorja buxhetore

Në bazë të strategjisë së miratuar fiskale dhe shumave të përcaktuara maksimale të mjeteve të aprovuara, Ministria për financa është e obliguar që deri më 15 qershor, të gjithë shfrytëzuesve të mjeteve buxhetore dhe fondeve, t'u parashtrijë udhëzime në formë të Qarkores buxhetore, me qëllim të parashtrimit të kërkesës për hartimin e Propozim-buxhetit.

Ministria për financa ia dorëzon Qarkoren Kryetarëve të komunave më së voni deri më 30 shtator.

Qarkorja buxhetore për Buxhetin e Republikës së Maqedonisë

Qarkorja i përmban elementet në vijim për përgatitjen e propozimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë:

- proeksinin për agregatet makroekonomike, të cilat përmbahen në strategjinë e miratuar fiskale;
- prioritetet e caktuara strategjike të Qeverisë, me propozimin e programeve rrjedhëse dhe nënprogrameve të Qeverisë,
- shumat maksimale të mjeteve të aprovuara sipas fushave funksionale të pushtetit qendror dhe fondeve, të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë,
- udhëzimet dhe rekomandimet për përgatitjen e kërkesave të propozim-buxhetit, dhe
- informatat tjera të nevojshme.

Qarkorja buxhetore për komunat

Qarkorja buxhetore për komunat i përmban këto elemente:

- informatat për guesit rrjedhës dhe të vlerësuar makroekonomikë të Republikës së Maqedonisë;
- informatat për vlerësimin e të hyrave për vitin buxhetor të cilat ndahen mes Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe komunave;
- prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë;
- parametrat e veçantë të cilët aplikohen për shpërndarjen e pjesëmarrjes së aprovuar të të hyrave nga TVSH e komunave, dhe

- informatat për vendimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për dotacionet e dedikuara, bllok-dotacionet dhe dotacionet tjera për komunat, të përcaktuara me ligj.

Hapi IV: Parashtrimi i kërkesave buxhetore

Shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror dhe fondeve hartojnë propozime të kërkesave të buxhetit, në pajtim me udhëzimet dhe rekomandimet e Qarkores për: buxhetin themelor, buxhetin e donacioneve, buxhetin e borxheve dhe buxhetin e aktiviteteve të vetëfinancimit.

Në pajtim me udhëzimet dhe rekomandimet e Qarkores, shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror dhe fondet hartojnë propozime të kërkesave buxhetore për aktivitetet e tyre të përfshira me programet, nënprogramet dhe planet strategjike, dhe i parashtrojnë ato tek bartësit e fushave funksionale.

Përmbajtja e kërkesës buxhetore

- Kërkesa buxhetore përmban:
- Qarkore të plotësuar;
- Plan strategjik të shfrytëzuesit buxhetor për vitin vijues fiskal;
- Plan për furnizimet publike;
- Arsyetim për kërkesën për projektet e reja kapitale;
- Arsyetim për kërkesën për vazhdimin e projekteve kapitale në vitin vijues fiskal;
- Informata tjera në pajtim me udhëzimet dhe rekomandimet e Qarkores.

Hapi V: Dakordimi i kërkesave buxhetore

Ministria e financave e kontrollon pajtueshmërinë e propozimit të kërkesave buxhetore, nga aspekti i shumave të aprovuara maksimale të mjeteve të aprovuara për fushën funksionale të pushtetit qendror dhe fondet me udhëzimet dhe rekomandimet e Qarkores, dhe nga aspekti i efikasitetit, prioritetit dhe racionalitetit të kërkesës.

Propozimet e kërkesave buxhetore të cilat nuk janë në pajtim me të lartëcekurën, kthehen për dakordim. Kërkesat e dakorduara buxhetore të shfrytëzuesve buxhetorë dhe fondeve parashtrohen në Ministrinë e financave më së vonë në afat prej 7 ditëve nga dita e kthimit të propozimit të kërkesës buxhetore.

Faza e dytë: Miratimi i buxheteve

Hapi I: Ministria për financa ia parashtron Qeverisë Propozimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, më së voni deri më 1 nëntor të vitit vijues.

Propozimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë e përmban:

- përmbledhjen e treguesve makroekonomikë, politikave ekonomike (përfshirë këtu edhe politikën për investime publike),
- përmbledhjen e programeve të Qeverisë, të përfshira në Buxhet,
- përmbledhjen e programeve të shfrytëzuesve buxhetorë, të përfshira në Buxhet,
- përmbledhjen e propozimit të buxhetit sipas klasifikimit funksional, klasifikimit ekonomik dhe programeve të Qeverisë,
- planin e propozuar të të hyrave dhe shpenzimeve tjera, dhe mjeteve të aprovuara për shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së parë sipas paragrafeve, programeve dhe nënprogrameve, dhe sipas buxheteve, gjegjësisht burimeve të financimit,
- kornizën buxhetore afatmesme, përfshirë këtu edhe të hyrat e planifikuara dhe të hyrat tjera, si dhe mjetet e aprovuara të cilat priten, sipas fushave funksionale të buxhetit qendror dhe fondeve,
- detyrimet e ndërmarra afatmesme në bazë të bashkëfinancimit, për programet e Qeverisë me pasqyrimin e detyrimeve të ndërmarra për pjesëmarrjen buxhetore të aktiviteteve të cilat financohen me borxhe dhe donacione,
- të dhënat për projektet e investimeve kapitale sipas programeve,
- të dhënat për borxhin e papaguar nga fillimi deri në fund të vitit, përfshirë këtu edhe borxhin e ri dhe planifikimin për pagesën e tij, dhe
- të dhënat tjera të nevojshme.

Hapi II: Parashtrimi i Propozimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë në Kuvend

Propozim-Buxhetin e Republikës së Maqedonisë Qeveria ia dorëzon Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, më së voni deri më 15 nëntor të vitit rrjedhës.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë nuk mund ta shqyrtojë Propozim-Buxhetin e Republikës së Maqedonisë para se të kalojnë 20 ditë nga dita e parashtrimit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Ministri për financa e prezenton Propozimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Në procedurën për miratimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, secila rritje e mjeteve të propozuara për aprovim duhet të shoqërohet me zvogëlim adekuat të mjeteve tjera të propozuara për aprovim. Rezerva e Propozimit të Buxhetit nuk mund të zvogëlohet për rritjen e artikujve tjerë buxhetorë.

Secili deputet i Kuvendit, dhe grupet parlamentare kanë të drejtë të parashtrorjnë amendamente për Propozimin e Buxhetit. Kopja e secilit amendament duhet t'i dorëzohet të gjithë deputetëve para fillimit të diskutimit.

Diskutimi për Propozimin e Buxhetit duhet të mbahet gjatë muajit dhjetor. Ministri i financave duhet ta prezentojë Propozimin e Buxhetit në Kuvend. Në këtë seancë diskutohet për secilin protokoll të përcaktuar. Në fillim diskutohet në përgjithësi për Propozimin e Buxhetit, pastaj për secilin amendament ndaras, dhe në fund votohet për tekstin e Propozimit të Buxhetit. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miraton Buxhetin e Republikës së Maqedonisë më së voni deri më 31 dhjetor.

Përmbajtja dhe procedura për miratimin e buxheteve komunale përcaktohet me Ligjin për financimin e NJVL-ve. Këshillat komunalë i miratojnë buxhetet më së voni deri më 31 dhjetor të vitit rrjedhës.

E drejta shpenzimit të përkohshëm

Në rast se Buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitin vijues nuk miratohet deri më 31 dhjetor të vitit rrjedhës, Ministria për financa e aprovon shfrytëzimin e mjeteve mujore, më së shumti deri në një të tretën e shpenzimeve të përgjithshme për kuartalin e parë të vitit fiskal, më së voni deri më 31 mars, duke i pasur parasysh qarkullimet e pagesave të gatshme. Në këtë periudhë nuk ndërmerren detyrime të reja dhe nuk realizohen shpenzime për programe të reja.

Me miratimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, të gjitha mjetet e aprovuara për vitin rrjedhës të cilat janë shfrytëzuar deri atëherë, përfshihen në buxhetin e miratuar.

Buxheti i miratuar publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, për dallim nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale, të cilat publikohen në gazetata zyrtare të njësive të vetëqeverisjes lokale.

Faza e tretë: Realizimi i buxheteve

Realizimi i buxheteve e përfshin arkëtimin dhe evidentimin e të hyrave dhe derdhjeve tjera në pajtim me planin e të hyrave, si dhe realizimin e pagesave në pajtim me mjetet e aprovuara.

Gjatë realizimit të buxhetit nevojitet plotësimi efektiv dhe efikas i qëllimeve të programit buxhetor, përmes procedurave transparente.

Efektiviteti e nënkupton realizimin e qëllimeve të parashtruara, në pajtim me buxhetin në afatet e parashikuara, kurse efikasiteti e nënkupton realizimin e tyre me shfrytëzimin e shumës minimale të mjeteve.

Arkëtimi i të hyrave dhe të mjeteve tjera bëhet në pajtim me ligjin.

Hapi I: Parashtrimi i planit financiar vjetor

Pas miratimit të Buxhetit, Ministria e financave i informon shfrytëzuesit dhe njësitë e shfrytëzuesve për mjetet e aprovuara nga Buxheti. Por, shfrytëzuesit e mjeteve të Buxhetit mund t'i shfrytëzojnë mjetet vetëm në qoftë se në afat prej 25 ditëve nga miratimi i Buxhetit ia parashtrojnë Ministrisë për financa planin vjetor sipas kuartaleve, për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve sipas programeve, llogarive dhe paragrafeve.

Shfrytëzuesit e mjeteve të Buxhetit të cilët kanë njësi të shfrytëzuesve janë të obliguar që në afat prej 5 ditëve nga miratimi i Buxhetit, secilës njësi të shfrytëzimit t'ia dorëzojnë ekstraktin e planit financiar vjetor sipas llogarive, programeve dhe paragrafeve, ku përmbahen mjetet e dedikuara për secilën njësi të shfrytëzimit.

Hapi II: Parashtrimi i planit financiar kuartal

Në bazë të planit financiar vjetor, shfrytëzuesit buxhetorë janë të obliguar që gjatë vitit të hartojnë propozime të planit financiar për kuartalet e caktuar, sipas muajve, llogarive, programeve dhe paragrafeve, të cilat ia parashtrojnë Ministrisë për financa - Sektorit të thesarit, më së voni në afat prej 5 ditëve nga fillimi i kuartalit të dhënë, me qëllim të aprovimit.

Plani financiar kuartal i ndarë sipas muajve, është vlerësim për shpenzimet e shfrytëzuesve të Buxhetit për periudhën e caktuar (kuartalin).

Hapi III: Aprovimi i planeve financiare kuartale dhe realizimi i Buxhetit

Sektorit për thesar i Ministrisë për financa i shqyrton dhe aprovon planet financiare kuartale, me çka mundësohet shpenzimi i mjeteve për muajt e dhënë në suazat e kuartalit, gjegjësisht periudhës vijuese, në qoftë se kjo e drejtë mbetet e porealizuar.

Për kryerjen e pagesave të tyre, shfrytëzuesit dhe njësitë e shfrytëzuesve të mjeteve të Buxhetit, fondeve dhe njërive të vetëqeverisjes lokale, i parashtrojnë Ministrisë për financa kërkesë për pagesë, në formularin e përcaktuar nga Ministri i financave.

Për kryerjen e pagesave të shfrytëzuesve dhe njërive të shfrytëzuesve të mjeteve të Buxhetit, Ministri i financave e kontrollon pajtueshmërinë e kërkesës me buxhetin vjetor të shfrytëzuesit dhe planin financiar, dhe saldon e llogarisë gjegjëse të shfrytëzuesit të Buxhetit. Pas kësaj, Ministri e aprovon kërkesën për realizim dhe e kryen pagasën nga llogaria e thesarit, për çka e informon shfrytëzuesin e Buxhetit,

gjegjësisht njësinë e shfrytëzuesit. Pagesat e kryera evidentohen në regjistrin kryesor të thesarit.

LLOGARIA PËRFUNDIMTARE E BUXHETEVE

Ministri i financave është i obliguar që deri më 31 maj t'ia parashtrorë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë llogarinë përfundimtare të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, e cila paraprakisht i është nënshtruar revizionit nga Enti shtetëror për revizion, si dhe Raportit të revizorit të autorizuar shtetëror, së bashku me komentet e Ministrisë për financa. Me llogarinë përfundimtare të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë parashtrohen edhe llogaritë përfundimtare të buxheteve komunale.

Pas konfirmimit të llogarisë përfundimtare nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, ajo i dorëzohet Kuvendit për shqyrtim dhe aprovim, më së voni deri më 30 qershor.

Llogaria përfundimtare e buxheteve komunale miratohet në pajtim me ligjin.

Forma dhe përmbajtja e llogarive përfundimtare të paragrafit (1) të këtij neni përcaktohen nga Ministri i financave.

3. Transparenca e buxheteve

Raporti gjysëmvjetor për realizimin e Buxhetit

Raportet për realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë publikohen në web-faqen e Ministrisë për financa në bazë mujore.

Ministri i financave deri më 31 korrik të vitit fiskal ia parashtron Qeverisë raportin për realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për gjashtë muajt e parë.

Raporti për realizimin e buxheteve komunale përgatitet në pajtim me Ligjin për financimin e njërive të vetëqeverisjes lokale. Konkretisht, Kryetarët e komunave janë të obliguar t'i parashtrorë Ministrisë për financa dhe Këshillave komunalë raporte të elaboruara kuartale për realizimin e buxhetit.

Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe llogaria përfundimtare e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë publikohen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë"

Buxheti komunal dhe llogaria përfundimtare e buxhetit komunal publikohen në gazetat zyrtare të komunës.

Shfrytëzuesit buxhetorë dhe njësitë e shfrytëzuesve buxhetorë duhet ta mbajnë kontabilitetin dhe të kryejnë revizion të brendshëm në pajtim me ligjin.

Risitë në procesin buxhetor

Ministria e financave e Republikës së Maqedonisë e përcjell praktikën e shteteve të Bashkimit Evropian në menaxhimin me financat publike, në veçanti në pjesën e lidhur me planifikimin buxhetor dhe prezentimin e Buxhetit.

Klasifikimi i ri ekonomik i të dalave e mundëson planifikimin e Buxhetit dhe unifikimin e raporteve buxhetore sipas definicioneve të pranuar në nivel ndërkombëtar për llojet e caktuara të të dalave, dhe standardet për raportim të përcaktuara nga Fondi monetar ndërkombëtar.

Zhvillimi i planifikimit strategjik dhe aplikimi i planeve strategjike të institucioneve buxhetore kanë qenë baza për ndarjen e aktiviteteve dhe projekteve në programe dhe nënprograme të veçanta. Përgatitja e buxhetit ka fituar rëndësi më të madhe për institucionet buxhetore, me çka i është dhënë prioritet financimit të qëllimeve dhe prioriteteve strategjike, në llogari të aktiviteteve me rëndësi më të vogël. Njëherazi janë ndërmarrur edhe përpjekje për ndarjen e aktiviteteve dhe politikave qeveritare si programe dhe nënprograme të veçanta të unifikuara, të cilat realizohen në suazat e më tepër institucioneve buxhetore. Me avancimin e buxhetimit programor dhe përshkrimin e programeve sigurohen të dhëna të detajuara për mjetet buxhetore të aprovuara për Programet qeveritare, aktivitetet e institucioneve buxhetore dhe projekteve të investimeve kapitale.

Procesi i reformës së planifikimit buxhetor vazhdon edhe më tej, me qëllim të sigurimit të vazhdueshmërisë së proceseve të filluara, dhe inkorporimin e risive të cilat do të kontribuojnë për buxhetim më të mirë, më transparent dhe më të suksesshëm.

Si prioritet na imponohet nevoja për zhvillimin e treguesve të posaçëm për suksesin e programeve, përmes të cilave do të mundësohet matja e rezultateve të realizimit të programeve dhe nënprogrameve. Për këtë qëllim do të realizohet trajnimi i kuadrit kompetent për përgatitjen e buxhetit të të gjitha institucioneve buxhetore. Për ta implementuar këtë reformë në mënyrë të suksesshme, e cila është e rëndësishme nga aspekti i vlerësimit të arsyeshmërisë ekonomike të programeve dhe nënprogrameve, nevojitet përfshirja e personave kompetent për realizimin e programeve të caktuara.

Zhvillimi i buxhetimit kapital është segmenti vijues, i cili kërkon përkushtim të posaçëm, dhe koordinim të plotë të të gjitha institucioneve buxhetore. Planifikimi i plotë i projekteve kapitale ka rëndësi qenësore për realizimin e tyre të suksesshëm dhe në kohën e duhur. Shfaqja e projekteve si nënprograme të veçanta kapitale, së bashku me dinamikën e realizimit të projekteve sipas viteve dhe muajve, dhe konstruksioni i detajuar financiar do të japin pasqyrë të plotë për arsyeshmërinë e projekteve, dhe njëherazi do ta mundësojnë realizimin e të gjitha aktiviteteve të lidhura me projektin, në kohën e duhur. Kjo informatë do ta mundësojë përmirësimin e politikës së investimeve publike, shpërndarjen e projekteve kapitale dhe shfrytëzimin efektiv të mjeteve financiare. Qëllimi i Ministrisë për Financa është të sigurohet se aktivitetet e lidhura me projektet kapitale nuk do të prolongohen, dhe se do të realizohet pagesa e punësve të kryera gjatë vitit, në kohën e duhur.

Ndërlidhja adekuate e politikave buxhetore të RM me procesin e planifikimit të buxhetit është një prej qëllimeve të reformës. Korniza fiskale disavjeçare e cila është në realizim e sipër, e mundëson shfrytëzimin e kornizës buxhetore afatmesme. Korniza buxhetore afatmesme siguron kufizime të planifikuara për funksionet e posaçme të Qeverisë, me çka i jepet mundësi udhëheqësve të resoreve të njihen në mënyrë të detajuar me shumat e projektuara të mjeteve për dy vitet e ardhshme, të cilat i takojnë resoreve gjegjëse.

Me aplikimin e kufizimeve (shumat maksimale të të dalave) të fushës funksionale nga fillimi i vitit, sigurohet fleksibiliteti i mjaftueshëm i ministrive, të cilat mund t'i realizojnë politikat me prioritet edhe në rastet kur nuk priten shuma më të mëdha të mjeteve plotësuese, përmes mënjanimit të aktiviteteve joesenciale.

KAPITULLI IV. Kontrolli, gjegjësisht mbikëqyrja e Buxhetit

Diskutimi themelor dhe shpjegimi i nocioneve

Tashmë e dimë se buxhetet janë një lloj i mekanizmit për mbledhje, shpërndarje dhe shfrytëzim të resurseve. Ato janë instrumente të cilat i shfrytëzojnë Qeveria për definimin e prioriteteve, për shembull, për të caktuar se sa të holla do të investohen në shëndetësinë publike, arsim, përfaqësimin e barabartë të pakicave nacionale ose çrrënjosjen e varfërisë. Buxhetet nuk janë të pakufizuara, dhe qeveritë duhet të vendosin se në cilën mënyrë do t'i shfrytëzojnë mjetet e disponueshme. Madje as qeveritë e shteteve më të pasura nuk mund t'i plotësojnë kërkesat e të gjithë shfrytëzuesve të buxhetit, dhe kanë rol në vlerësimin e kërkesave, dhe vendim-marrje për kërkesat dhe shumat e ndara. Roli i asociacioneve qytetare është mbikëqyrja e shpërndarjes së këtyre mjeteve, vlerësimi i dedikueshmërisë së veprimeve adekuate dhe transparenca në shpenzimin e mjeteve.

Vetë procesi i buxhetimit dhe sistemi buxhetor janë kritere kryesore për sistemin e hapur, demokratik dhe pjesëmarrës të sundimit. Në përgjithësi, në shumë shtete mungojnë informatat për çështjet buxhetore. Veçanërisht mungojnë informatat për opinionin publik, të cilat do të prezentohen në mënyrë të thjeshtë, dhe do të kuptohen. Në të shumtën e rasteve buxhetet prezentohen me gjuhë teknike, dhe qytetarët e kanë vështirë të kuptojnë se ku shpenzohen të hollat shtetërore. Mungesa e informatave të përpikta i pamundëson qytetarët dhe organizatat qeveritare të marrin pjesë në diskutimin për shpërndarjen e resurseve publike. Ndonjëherë edhe vetë korniza ligjore e pamundëson pjesëmarrjen efektive të sektorit qytetar në procesin buxhetor. Kjo është arsyeja se pse është e rëndësishme që sektori qytetar të merr pjesë në mbikëqyrjen e buxheteve, dhe të llojë për kushtet të cilat do ta mundësojnë vendim-marrjen transparente për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore. Gjatë kontrollimit të buxheteve duhet të merren parasysh tre parime themelore:

Qasja ndaj informatave buxhetore: një prej çështjeve më të rëndësishme për punën financiare transparente është që opinionit publik t'i dorëzohen me kohë informatat buxhetore, të cilat janë mbarëpërfshirëse, të sakta dhe të kontrolluara.

Kontrollimi i pavarur i realizimit të buxhetit dhe kontrollimi i të dhënave të cilat i publikon qeveria: kontrollimi i të dhënave, dhe kontrollimi i realizimit të buxhetit janë të rëndësishme për ta vërtetuar realizimin e aktiviteteve dhe programeve të pushtetit, për të cilat janë zotuar gjatë miratimit të buxhetit.

Miratimi i buxhetit: është tepër e rëndësishme të shihet ekzistimi i mundësive për përfshirjen e sektorit qytetar në miratimin e buxheteve në nivel nacional dhe lokal, parashtrimin e pikëvështrimeve dhe aprovimin e tyre.

Nga ana tjetër, çka është e rëndësishme gjatë mbikëqyrjes së buxheteve? Së pari duhet ta sqarojmë nocionin e mbikëqyrjes. **Mbikëqyrja** është proces i vazhdueshëm i mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, për të parë se në cilën mënyrë një projekt, program ose politikë publike realizohet, dhe në veçanti të shihet matja e

realizimit në aspekt të qëllimeve të projektuara ose pritjeve. Në këtë kuptim, **mbikëqyrja e buxheteve** mund të definohet si aktivitet ku do të hulumtohet, studiohet dhe mbikëqyrret retorika e pushtetit dhe zyrtarëve shtetërorë në aspekt të përkushtimeve të dhëna dhe afateve kohore. Analiza lidhet me pritjet e premtimeve, gjegjësisht proektimet për realizimin e aktiviteteve me paragrafe buxhetore, për të parë se sa mjete janë shpenzuar. Analiza cilësore është baza e aksionit qytetar të lidhur me realizimin e buxheteve. Asociacionet qytetare duhet së pari të kenë kapacitet për analizën e këtyre informatave, dhe të gjitha të dhënave tjera joformale të cilat mund t'i marrin përmes kanaleve joformale. Rëndësi më të madhe ka shndërrimi i punës analitike në të dhëna të kuptueshme për opinionin publik, gjegjësisht mediat dhe hartuesit e politikave, dhe këto të dhëna të shpërndahen sa më tepër.

Dy pyetjet themelore për kontrollimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit janë kush e ushtron atë, dhe çka kontrollohet dhe mbikëqyrret saktësisht? Në vijim jepen disa parametra themelore për kontrollimin dhe mbikëqyrjen e buxheteve:

- **korupsioni** - a janë të korruptuar përfaqësuesit e popullit në nivel nacional dhe lokal, a i vjedhin të hollat tona, a ka korupsion?
- **definimi i prioriteteve (vendimet politike në punë)** - a janë prioritetet e bashkësisë bazë për miratimin e vendimeve sipas të cilave shpenzohen të hollat e buxhetit? E dimë se mjetet e buxhetit mund të shfrytëzohen për qëllime të ndryshme, duke filluar nga nevojat e shkollës fillore lokale, ndërtimin e sistemit të ri të kanalizimit, deri te rregullimi i rrugëve. Për në është me rëndësi të shohim se si shpenzohen të hollat e popullit, të hollat e buxhetit, dhe a miratohen vendimet në mënyrë transparente? Është e rëndësishme të shohim se sa mjete ndahen për secilin qëllim, për shembull, sa të holla buxhetore planifikohen për ndërtimin e rrugës lokale, dhe sa për shkollën fillore. Është e rëndësishme të shohim se pse është vendosur ky raport në shpenzimet e të hollave buxhetore, dhe a bazohet ky vendim në nevojat reale të qytetarëve.
- **pyetja për shpenzimin efikas të mjeteve buxhetore** - a shpenzohen të hollat buxhetore në mënyrë ekonomike, efikase dhe të dobishme për të gjithë qytetarët? Për shembull, nëse shpenzohen nga 1000 denarë për ushqimin e një nxënësi në një komunë të caktuar, si është e mundur të shpenzohen 2000 denarë për ushqimin e një nxënësi tjetër në një shkollë fqinje. A transferohen me të vërtetë të hollat në llogarinë e shkollës lokale ose ambulantsë lokale në shumë të parapara me buxhet? Çka bën ekipi menaxhues i shkollave me këto të holla, për çka i shpenzon ato, çka blen dhe në çfarë sasi?

Politikat publike (public policy) në Maqedoni mund të definojnë si: aktivitete ose vendime/ ligje të qeverisë (në nivel lokal ose qendror) për menaxhimin e problemeve praktike ose zgjidhjen e çështjeve politike të cilat jo çdoherë miratohen në bazë të informatave të reja ose të detajuara për efektet e politikave të këtyra. Procesi i formimit dhe ndryshimit të politikave publike mund të përshkruhet me hapat në vijim: formulimi i politikës publike, realizimi ose implementimi i pjesërishëm ose i plotë, dhe

shumë rrallë, mbikëqyrja e efekteve të politikës publike. Për tu siguruar se kemi shfrytëzim efikas të mjeteve publike në procesin e decentralizimit fiskal në Maqedoni, është mirë të prezentojmë, gjegjësisht të pranojmë një mbikëqyrje adekuate të realizimit ose shfrytëzimit të buxheteve në nivel qendror, dhe në veçanti në nivel lokal. **Pse? Për shkak se buxheti nuk do të realizohet në mënyrë efikase në qoftë se nuk kryejmë mbikëqyrje cilësore.**

Ndonëse decentralizimi mund t'i komplikojë mundësitë për mbikëqyrje të koordinuar të buxheteve në nivel shtetëror, ai jep mundësi për pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në procesin e miratimit të buxhetit dhe shfrytëzimin e tij. Problemi më i madh te decentralizimi është mungesa e kapaciteteve të institucioneve lokale. Në këto raste, asociacionet qytetare mund ta imponojnë agjendën e mbikëqyrjes së buxheteve. Në procesin e decentralizimit, Republika e Maqedonisë është obliguar ta kryejë bartjen e një pjese të detyrave dhe obligimeve nga niveli qendror në nivelin e pushtetit lokal. Në përgjithësi, në këtë mënyrë krijohen më tepër mundësi për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset demokratike. Përgjegjësia e pushteteve lokale është më e madhe në shumë sfera - shëndetësi primare, institucione kulturore, mirëmbajtje, transport dhe ushqim të nxënësve në arsimin fillor. Në kuadër të procesit të decentralizimit, rëndësi të posaçme kanë mekanizmat për kontrollimin qytetar dhe mbikëqyrjen e buxheteve. Arsyeja për të cilën qytetarët e mbikëqyrin buxhetin, është të sigurohemi se bashkësitë lokale i njohin të drejtat dhe obligimet e tyre.

1. Kush janë aktorët?

Kush është përgjegjës për realizimin e Buxhetit? Kemi thënë se kjo është Qeveria (në nivel shtetëror dhe lokal), gjegjësisht ministritë dhe shfrytëzuesit tjerë të mjeteve buxhetore. Është e rëndësishme të theksojmë se rol të posaçëm në realizimin e Buxhetit dhe kontrollimit të realizimit të tij kanë Ministria për financa, thesari, revizioni shtetëror, revizioni i brendshëm, dhe në fund, kuptohet, qytetarët. Përveç rolit të tyre, në këtë kapitull do të shqyrtohet edhe roli i qytetarëve dhe asociacioneve qytetare në procesin e miratimit të buxheteve.

2. Kontrolli financiar publik dhe roli i Entit shtetëror për revizion

Në pajtim me Ligjin për revizion shtetëror,⁷ Enti shtetëror për revizion (ESHR) e kryen revizionin shtetëror dhe revizionin e njërive të vetëqeverisjes lokale. Revizioni shtetëror kryhet nga ana e revizorëve të autorizuar shtetërorë, dhe revizorëve shtetërorë të ESHR-së. Gjatë ushtrimit të revizionit, revizorët e autorizuar kanë "qasje të lirë në lokalet dhe pronën zyrtare, të drejtë për kontrollimin e regjistrave, formularëve dhe dokumentacionit tjetër, si dhe të drejtë për kërkimin e shpjegimeve nga përfaqësuesit e subjektit ku ushtrohet revizioni për të gjitha çështjet e rëndësishme për ushtrimin e revizionit" (neni 24). Revizioni kryhet nga ekipi i përbërë prej disa revizorëve

⁷ "Gazeta Zyrtare" 73/04, verzioni i pastruar

(varësisht nga madhësia dhe kompleksiteti i personit juridik ku kryhet revizioni, gjegjësisht komuna), i cili udhëhiqet nga menaxheri i ekipit. Pas përfundimit të revizionit, revizori i autorizuar harton draft-raport të cilin komuna mund ta komentojë në afat prej 15 ditëve. Pas shqyrtimit të komenteve hartohet raporti final, i cili i dorëzohet komunës dhe Ministrisë për financa, si dhe ministrive tjera "kompetente për kryerjen e punëve në fushën e veprimit, gjegjësisht ingjerençave të subjektit i cili ka qenë objekt i revizionit" (neni 27). Në rast se komuna ka ankesa, revizori shtetëror merr vendim në afat prej 30 ditëve. ESHR i parashtron Kuvendit Raport vjetor për punën e tij, dhe Kuvendi duhet ta miratojë atë.

3. Kontrolli financiar publik dhe roli i Revizionit të brendshëm dhe Ministrisë për financa

Realizimi i kontrollit të brendshëm financiar, menaxhmenti financiar dhe kontrollimi i njësive të vetëqeverisjes lokale rregullohet me Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, dhe ligjeve në vijim:

- Ligji për buxhete⁸,
- Ligji për realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë⁹,
- Ligji për kontabilitet dhe shfrytëzuesit buxhetorë¹⁰,
- Ligji për revizion në sektorin publik.¹¹

Këto ligje e sigurojnë ekzistimin e një sistemi të kontrollimit të rregullt dhe të brendshëm të kontabilitetit (ex-post), i cili ushtron mbikëqyrje për realizimin e transaksioneve financiare në suazat e ligjit, ekzistimit të dokumentacionit adekuat të kontabilitetit, dhe sigurimit të informatave të plota dhe autentike të raporteve financiare për transaksionet financiare.

Me procesin e decentralizimit, komunat kanë rol më të madh gjatë revizionit të brendshëm të punës së pushteteve lokale. Në kuadër të komunës ekzistojnë sektore/ seksione të posaçme të revizionit të brendshëm. Këto njësi janë të pavarura nga organet tjera komunale, dhe të mëvetësishme. Revizori i brendshëm është përgjegjës vetëm për realizimin e revizionit, dhe nuk guxon të ketë detyra tjera në komunë. Të punësuarit e këtyre njësive janë nëpunës shtetërorë. Në kuadër të komunës, kontabilisti i autorizuar është përgjegjës për kontrollimin ex ante të dokumenteve të kontabilitetit.

Ministria për financa ka qenë përgjegjëse për zhvillimin dhe harmonizimin e njësive të revizionit të brendshëm në kuadër të vetëqeverisjes lokale. Kjo ministri ka rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e shfrytëzimit të mjeteve buxhetore. Në Ministrinë për financa ekzistojnë tre sektore të cilat kryejnë kontrollim të brendshëm financiar: Sektori

⁸ "Gazeta Zyrtare" 79/93, 3/94, 71/96, 46/00, 11/01, 93/01, 46/02, 24/03, 85/03 dhe 96/04.

⁹ "Gazeta Zyrtare" 96/04.

¹⁰ "Gazeta Zyrtare" 61/02 dhe 98/02.

¹¹ "Gazeta Zyrtare" 69/04.

për buxhete dhe fonde, Sektori për thesar dhe Sektori për revizion të brendshëm financiar. Sektori i fundit përbëhet prej dy seksioneve - Njësia për harmonizim qendror dhe Njësia për revizion të brendshëm, e cila është përgjegjëse për revizionin e brendshëm të enteve publike të cilat nuk kanë njësi vetanake për revizion të brendshëm.

4. Roli i qytetarëve të Maqedonisë në procesin e mbikëqyrjes së buxheteve

Sistemi juridik i Republikës së Maqedonisë nuk e garanton drejtëpërdrejtë të drejtën e qytetarëve për përfshirje në procesin e hartimit të buxheteve dhe shfrytëzimit të tyre. Si që kemi parë paraprakisht, supozohet që mbikëqyrja, gjegjësisht kontrollimi financiar të kryhen nga organet shtetërore. Prapëseparë, ligjet nuk e përjashtojnë mbikëqyrjen qytetare të shfrytëzimit të buxhetit. Në nivel nacional, ekziston e drejta kushtetuese për propozimin e ligjeve dhe ndryshimin e akteve ekzistuese ligjore, e drejta për të ndikuar përmes deputetëve në dokumentet e miratuara nga Kuvendi, e drejta e marrjes së informatave sipas Ligjit për qasje ndaj informatave, dhe ekzistojnë zyrat për kontakt me qytetarët, pyetjet e deputetëve dhe mekanizma të ngjajshëm. Madje mund të thuhet se në nivel lokal qytetarët inkurajohen të ndër marrin aktivitete të këtitilla, në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale. Kushtetuta dhe Ligji për vetëqeverisje lokale konfirmojnë se njësitë e vetëqeverisjes lokale e gëzojnë të drejtën e vetëqeverisjes lokale, *përmes pjesëmarrjes të drejtëpërdrejtë të qytetarëve*, gjatë vendim-marrjes së lidhur me interesat e përgjithshëm ose të qytetarëve (shiqo tekstin e nenit 5).

Përveç kësaj, mbledhjet në të cilat diskutohet për buxhetin komunal, llogarinë vjetore të buxhetit dhe planet urbanistike, nuk mund të jenë të mbyllura për opinionin publik. Është e rëndësishme të theksohet se pas skadimit të vitit fiskal, Këshilli komunal e miraton llogarinë vjetore të buxhetit të komunës. Llogaria vjetore i përmban të gjitha të hyrat dhe të dalat e planifikuara dhe të relizuara, për të gjithë shfrytëzuesit e buxhetit komunal. Pas miratimit të llogarisë vjetore, Kryetari i komunës e informon opinionin publik për përmbajtjen e saj. Ndonëse korniza ligjore e Republikës së Maqedonisë nuk e garanton drejtëpërdrejtë mundësinë e mbikëqyrjes qytetare të buxhetit, ajo e mundëson këtë. Është çështje tjetër se a është mbikëqyrja në agjendën e asociacioneve qytetare dhe/ ose organizatave joqeveritare.

Roli i sektorit qytetar dhe organizatave joqeveritare është zhvillimi i sistemit efikas dhe transparent të mbikëqyrjes, i cili do ta promovojë realizimin e kujdesshëm të buxheteve të miratuara, me çka do të zvogëlohet korrupsioni dhe menaxhimi i keq me resurset publike. Ka lloje të ndryshme të aktiviteteteve, për shembull, organizatat joqeveritare mund të përqëndrohen në mbikëqyrjen e shpenzimit të mjeteve të buxhetit për dedikimet ose programet specifike të parapara, si për shembull ndërtimin e ndonjë shkolle ose rruge. Ata mund ta mbikëqyrin edhe realizimin e drejtë të politikave publike, dhe se a janë shpenzuar mjetet buxhetore për qëllimet e parapara, gjegjësisht a janë shpenzuar ato në mënyrë ekonomike.

Roli i sektorit qytetar do të jetë edhe më i madh pas miratimit të Ligjit për qasje ndaj informatave. Me këtë Ligj realizohet parimi kushtetues i cili e garanton

qasjen e lirë ndaj të dhënave, lirinë e pranimit dhe bartjes së informatave, si dhe publicitetin e punës së poseduesve të informatave. Nga ana tjetër, poseduesit e informatave janë të obliguar që opinionit publik t'i sigurojnë qasje ndaj teksteve të akteve, programeve, strategjive dhe dokumenteve tjera të lidhura me fushëveprimin e tyre, si dhe mënyrën në të cilën e bëjnë këtë.

Sipas Ligjit, do të formohet Komisioni për mbrojtjen e të drejtës të qasjes së lirë ndaj informatave me karakter publik, i cili do të jetë i pavarur në punën e tij, dhe miratimin e vendimeve në suazat e ingjercave të parapara me këtë Ligj. Mjetet për punën e Komisionit do të sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Komisioni e ka selinë në Shkup, dhe për punën e saj i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, të cilës i parashtron raport vjetor për punën e saj. Komisioni do të përbëhet prej pesë anëtarëve, prej të cilëve njëri është kryetar, dhe tjetri zëvendës i kryetarit. Anëtarët do të kenë mandat pesëvjeçar, me mundësi të rizgjedhjes, dhe do ta kryejnë punën e tyre në mënyrë profesionale. Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit bëhet nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, sipas propozimit të Qeverisë. Për realizimin e plotë të Ligjit në interes të qytetarëve, është esenciale që Komisioni të jetë me të vërtetë i pavarur, të ekzistojë vullnet politik për aplikimin e ligjit dhe administrata të jetë e trajnuar për dhënien e informatave të kërkuara nga qytetarët.

Buxheti pjesëmarrës (participativ)

Buxheti pjesëmarrës është qasje e re ndaj miratimit të buxheteve, i cili për herë të parë është aplikuar në nivel lokal në Brazil në vitin 1989, dhe ka krijuar interesim të madh në mbarë botën. Sipas kësaj mënyre të miratimit të buxheteve, opinioni publik është drejtëpërdrejtë i përfshirë në miratimin e vendimeve për politikën e nevojshme publike. Në këtë mënyrë, gjatë tërë procesit të miratimit të buxhetit mbahen forume të hapura. Opinioni publik ka mundësi të vendosë për mënyrën në të cilën do të shfrytëzohen mjetet shtetërore, për prioritetet e pushtetit në gjenerimin e politikave publike, gjegjësisht cilat politika publike duhet të realizohen urgjentisht, dhe në fund, ka mundësi të ushtrojë mbikëqyrje në shpenzimin e mjeteve buxhetore.

Në këtë mënyrë, buxhetimi pjesëmarrës e ndërpret traditën e marrjes së vendimeve buxhetore nga pushteti ekzekutiv dhe/ose ligjvënës. Në këtë mënyrë klasike të hartimit dhe miratimit të buxheteve, më së shpeshti përfshihet vetëm një grup i vogël i njerëzve, që është deficit i demokracisë. Gjatë buxhetimit pjesëmarrës, asociacionet qytetare të cilat ushtrojnë kontrollim dhe mbikëqyrje të buxheteve, ia dorëzojnë qytetarëve informatat e nevojshme. Përveç Brazilit, kjo mënyrë e buxhetimit është provuar edhe në vende tjera, si për shembull Buenos-Ajres në Argjentinë, dhe Kejptaun në Afrikën e Jugut.

Ndonëse ka ngajshmëri, nuk ekziston asnjë metodë e unifikuar e buxhetimit pjesëmarrës. Në qasjet e ndryshme të buxhetimit pjesëmarrës ndikojnë shumë faktorë, si për shembull konteksti politik dhe socioekonomik i shtetit ose komunës. Sidoqoftë, mund të definohen disa qëllime të përgjithshme të buxhetimit pjesëmarrës:

- Promovimi i pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe debatimit publik;
- Realizimi i drejtësisë sociale përmes përmirësimit të politikave publike dhe shpërndarjes së resurseve shtetërore, dhe
- Reformimi i administratës publike.

Në Maqedoni nuk ka mundësi ligjore për buxhetim pjesëmarrës, por duhet të mendohet për shfrytëzimin e diskutimeve publike para miratimit të vendimeve të rëndësishme, si për shembull miratimin e buxhetit vjetor në nivel komunal ose gjatë shqyrtimit të nevojës për ndryshimin e taksave për shërbimet lokale. Në faktat, mundësia për tubimet publike është paraparë me draftin e Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale. Fatkeqësisht, drafti i ligjit është shqyrtuar në mbledhjen e Qeverisë më 10 dhjetor 2003, ku është vendosur të mos përfshihet dispozita me të cilën pushtetet lokale obligohen të mbajnë tubime publike për buxhetet.

ANEKSI

A.) Fjalori i nocioneve

Buxheti - është dokument mbarëpërfshirës ku shpjegohen financat e qeverisë, në nivel qendror dhe lokal. Përbëhet nga të dhënat për të hyrat, të dalat, deficitin, suficitin dhe borxhin. Në përgjithësi, buxheti është një lloj i dokumentit ekonomik në të cilin pasqyrohen politikat publike të cilat do të ndërmerren nga pushteti në ndonjë periudhë të caktuar kohore. Ai e shpjegon politikën fiskale të pushtetit, pjesëmarrjen dhe ndikimin e qeverisë në ekonomi, dhe shpenzimin e të hollave publike. Zakonisht, buxheti hartohet nga pushteti ekzekutiv dhe i jepet për shqyrtim pushtetit ligjvënës për vlerësim dhe miratim. Buxheti miratohet në formë të ligjit, para fillimit të vitit fiskal.

Buxheti i baraspeshuar - është buxheti në të cilin të hyrat e përgjithshme të një viti fiskal janë të barabarta me të dalat e përgjithshme. Në rastet kur nuk ekziston baraspeshimi, ekziston suficitin ose deficitin buxhetor. Deficitin ekziston kur shpenzimet, gjegjësisht të dalat janë më të mëdha se të hyrat, dhe suficitin kur të hyrat i tejkalojnë të dalat.

Shfrytëzuesit buxhetorë - institucionet, ministritë, fondet dhe agjencitë tjeratë cilat financohen nga buxheti.

Buxheti i bazuar në rezultate (performance budgeting) - si koncept i përgjithshëm i buxhetit i cili i përfshin informatat për atë se çka duhet të arrihet me paragrafet e caktuara të

buxhetit. Konsiderohet se ky lloj i buxhetit i jep liri më të madhe menaxherëve ose drejtorëve të institucioneve për arritjen e qëllimeve të caktuara në realizimin e politikës publike. Në shumë shtete është vështirë të miratohet ky lloj i buxhetit, për shkak se nënkupton që për secilin paragraf buxhetor duhet të ekzistojë analizë për mjetet e nevojshme për realizim.

Borxhi publik i brendshëm - është borxhi, gjegjësisht huazimi i borxheve nga qeveria brenda shtetit, ku kreditorë kryesorë janë qytetarët, ndërmarrjet dhe institucionet financiare vendase.

Fondet jashtëbuxhetore - janë institucionet të cilat financohen me tatime specifike, ose të hyra tjera të qeverisë të cilat bazohen në tatime. Institucione të këtij lloji janë Fondi për shëndetësi dhe Fondi për sigurim pensional dhe invalidor.

Grantet - janë mjetet të cilat pushteti nacional i transferon në nivel lokal, organizatat joqeveritare ose individët. Disa prej granteve jepen për nevoja specifike, gjegjësisht parashohin që pranuesit të plotësojnë kushte të caktuara. Për shembull, pushteti qendror transferon grant për rrogat e të punësuarve në shkollat fillore ose tekstet shkollore të nxënësve. Në raste tjera, grantet e pushtetit qendror mund të shfrytëzohen për cilindo aktivitet ose qëllim.

Obliguesit tatimorë - të gjithë qytetarët ose ndërmarrjet të cilat i nënshtrohen tatimimit.

Tatimi i drejtëpërdrejtë - tatimi i cili paguhet drejtëpërdrejtë, për shembull **Borxhi (i qeverisë)** — shuma e të hollave të borxhit të qeverisë ndaj personave privatë ose institucioneve në një moment të caktuar. Qeveria merr borxh kur ka deficit, dhe borxhi zvogëlohet kur ka suficit. Borxhi i përgjithshëm është shuma e të gjitha borxheve të cilat bëhen çdo vit. Qeveritë mund të huazojnë drejtëpërdrejtë nga institucionet financiare dhe bankat. Gjithashtu, qeveria mund të lëshojë obligacione dhe letra me vlerë, të cilat ia shet personave ose bizneseve vendase ose të huaja. Kur blehen obligacionet, blerësit i huazojnë të holla qeverisë, me marrëveshje që borxhi të kthehet në datë të caktuar, dhe kamata do të paguhet në peirudha të ndryshme kohore. Kjo kamatë figuron si paragraf i të dalave buxhetore.

Enti shtetëror për revizion - institucion i pavarur kompetent për revizionin e buxhetit nacional, buxheteve të njësive të vetëqeverisjes lokale, fondeve, enteve shtetërore publike dhe të gjitha ndërmarrjeve të cilat plotësisht ose pjesërisht financohen nga buxheti.

Realizimi i buxhetit - shfrytëzimi i mjeteve buxhetore gjatë vitit sipas qëllimeve dhe programeve të përcaktuara në buxhet.

Sektori publik - në kuptimin më të gjërë nënkuptohen të gjitha nivelet e pushtetit (qendror dhe lokal) dhe ndërmarrjet publike.

Të hyrat kapitale - të hyrat nga shitja e të mirave, si për shembull tokave, ndërtesave, etj.

Projektet kapitale - projektet të cilat realizohen për periudhë më të gjatë

tatimi i fitimit, dhuratave dhe trashëgimis.

kohore (shkollat, spitalet, rrugët, urat) dhe me mjete më të shumta financiare.

Buxheti i konsoliduar - buxheti i cili fitohet pas kryerjes së transaksioneve mes buxhetit qendror dhe mjeteve jashtëbuxhetore

Mjetet e dedikuara buxhetore (shpenzimet) — mendohet në mjetet të cilat i transferohen ndonjë institucioni të caktuar, me qëllim që të shfrytëzohen për ndonjë program ose dedikim të caktuar.

Buxheti shumëvjeçar - buxheti i cili hartohet për periudhë më të gjatë se një vit.

Kontributet - mjetet të cilat paguhet në buxhet nga ana e punëdhënësve (kontributet për sigurim pensional dhe shëndetësor).

Të hyrat - mjetet të cilat qeveria i mbledh nga qytetarët, më së shpeshi në formën e tatimeve. Forma tipike të të hyrave janë tatimi mbi të ardhurat personale, tatimi i vlerës së shtuar, akcizat ose doganat. Shkalla progresive tatimore ekziston në rastet kur tatimi është më i madh për ata të cilët kanë të ardhura më të larta, dhe shkalla tatimore regresive në rastet kur tatimi është më i vogël për të ardhurat më të larta.

Ribalanci i buxhetit - ndryshimi në të hyrat dhe dalat e Buxhetit në aspekt të planifikimeve, zakonisht bëhet gjatë vitit fiskal.

Transparenca - transparenca fiskale dhe buxhetore ekziston atëherë kur opinioni publik ka qasje në informata të përgjithshme dhe të sakta për aktivitetet qeveritare të lidhura me buxhetin, dhe punën e saj financiare. Qytetarët kanë të drejtë të dinë se si

shpenzohen të hollat e tyre. Transparenca më e madhe e proceseve buxhetore e nënkupton edhe korrupsionin më të ulët, dhe përgjegjësinë e rritur.

Thesari - sistemi i menaxhimit të buxhetit dhe borxhit. E përfshin planifikimin, realizimin dhe supervizionin e resurseve të buxhetit.

Shpenzimet - lidhen me shpenzimet qeveritare. Shpenzimet bëhen për arritjen e ndonjë qëllimi të qeverisë. Shpenzimet e vërteta mund të dallohen nga ato të parashikuarat. Por, dallimi i

përhershëm mes këtyre dy kategorive do të thotë se ka dobësi në sistemin e buxhetimit të shtetit ose institucionit të caktuar.

Viti fiskal - periudha prej 12 muajve në të cilat shteti i planifikon dhe të hyrat dhe të dalat.

Kapaciteti fiskal - mundësitë e pushteteve lokale për financimin e aktiviteteve dhe shpenzimeve buxhetore përmes të hyrave vetanake.

B) Literatura

1. *Sistemi tatimor i Maqedonisë, Aspektet teorike dhe praktike, Ksente Bogoev, Zhivko Atanasovski*
2. *Proračunski vodič za građane, Katerina Ott*
3. *A Guide to Budget Work for NGO's, Isaac Shapiro*
4. *A Contemporary Approach to Public Expenditure Management, World Bank Institute*
5. *The Public Expenditure Management Handbook, The World Bank*
6. *A Citizen's Guide to the Budget, ed. Katarina Ott*
7. *Can civil society add value to budget decision-making,? Warren Krafchik*
8. *Follow the Money: A Guide to Monitoring Budgets and Oil and Gas Revenues, Jim Shultz*
9. *A Guide to Participatory Budgeting, Brian Wampler*
10. *Program Budgeting, Philip Rosenberg*
11. *A Guide to Revenue Issues and Analysis for NGO's (draft version, December 8, 2005), International Budget Project*
12. *A Citizen's Guide to the Budget, Elida Reci*

Ligjet

1. Ligji për buxhete
2. Ligji për realizimin e buxhetit, 2001
3. Ligji për realizimin e buxhetit, 2003
4. Ligji për realizimin e buxhetit, 2005
5. Ligji për taksat administrative, Ligji për taksat komunale
6. Ligji doganor
7. Ligji për tatimin personal
8. Ligji për tatimin mbi pasuri
9. Ligji për TVSH
10. Ligji për furnizime publike
11. Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale
12. Urdhëresa për metodologjinë e shpërndarjes të të hyrave të TVSH-së sipas komunave për vitin 2005
13. Rregullorja për metodologjinë e shpërndarjes së mjeteve të fondit të përbashkët të Qytetit të Shkupit dhe komunave të Qytetit të Shkupit
14. Buxheti i Komunës së Strumicës

Buletinet e Ministrisë për ekonomi

1. Buletini gusht/shtator 2005
2. Buletini tetor 2005
3. Buletini dhjetor 2005